

Në bazë të nenit 82 paragrafi 1 pika 2 të Kushtetutës së Malit të Zi dhe amendamentit IV paragrafi 1 të Kushtetutës së Malit të Zi, Kuvendi i Malit të Zi në mbledhjen e 25 -të, në takimin e seancës së parë të jashtëzakonshme për vitin 2015, më 26 shkurt 2015 miratoi

LIGJIN PËR ARMËT

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Ky ligj rregullon prokurimin, posedimin, mbajtjen, koleksionimin dhe transportin, si dhe kushtet për prodhimin, testimin dhe markimin e armëve të zjarrit, riparimin dhe modifikimin, tregtinë dhe transportin e armëve, ofrimin e shërbimeve të qitjes për qëllime sportive – rekreative dhe trajnimin e qytetarëve mbi përdorimin e rregullt të armëve të zjarrit.

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për:

- prokurimin, posedimin, mbajtjen, koleksionimin, transportin, prodhimin, testimin dhe markimin e armëve të zjarrit, modifikimin dhe riparimin, tregtinë dhe transportin e armëve, ofrimin e shërbimeve të qitjes për qëllime sportive dhe rekreative për nevoja të Ushtrisë së Malit të Zi (në vijim referuar si: Ushtria), të organeve administrative kompetente për punët e policisë (në vijim referuar si: Policia), si dhe të organeve të tjera shtetërore dhe personave juridikë kur parashikohet me ligj të veçantë;

- armët që transportohen përmes territorit të Malit të Zi për nevoja të organeve, organizatave, subjekteve tregtare dhe subjekteve të tjera shtetërore përkatëse, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 3

Armë konsiderohet çdo pajisje e prodhuar ose përshtatur, e cila nën presionin e ajrit, gazeve të barutit dhe gazeve të tjera ose ndonjë mekanizmi tjetër shtytës mund të hedhë fishek, sferë, saçmë ose predhë tjetër, pra që mund të përhapë gaz ose lëng, si dhe pajisjet e tjera të projektuara për qëllime mbrojtjeje, gjuetie ose sporti.

Për qëllimet e këtij ligji, armë konsiderohet çdo pjesë pajisjeje ose pjesë këmbimi që është e projektuar posaçërisht për armë zjarri dhe është e qenësishme për funksionimin e saj, duke përfshirë edhe pjesët kryesore të armës së zjarrit (mekanizmi mbyllës, tyta ose kasa, gryka ose foleja e fishekut), për blerjen e të cilës nevojitet leje.

Neni 4

Armët klasifikohen në kategoritë A, B, C dhe D.

Armë të kategorisë A janë:

- 1) predhat ushtarake me mbushje plasëse dhe sistem për lëshim;
- 2) armët e zjarrit automatike;
- 3) armët e zjarrit të kamufluara në formë të një mjeti tjetër;
- 4) municionin me shkallë të lartë depërtuese, municionin me predha shpërthyes ose ndezëse dhe predhat për këtë lloj municioni;
- 5) municionin për pistoleta dhe revolverë me predhë shpërndarëse dhe hapëse dhe predhat për këtë municion, përveç municionit për armët e gjuetisë ose për qitje sportive;
- 6) armët ushtarake;
- 7) armët plasëse dhe pjesët e tyre;
- 8) të gjitha llojet e armëve me silenciatorë të integruar dhe silenciatorë të destinuar për armën.

Armë të kategorisë B janë:

- 1) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetëimbushëse;
- 2) armët e shkurtra të zjarrit për një qitje, me ndezje qendrore;
- 3) armët e shkurtra të zjarrit për një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme deri në 28 cm;

4) armë e gjata gjysmautomatike me gushë ose folesë për fishekë që mund të mbajnë më shumë se tre fishekë;

5) armët e gjata gjysmautomatike zjarrit, me gushë ose fole për fishekë që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen me ndihmën e një mjeti të zakonshëm dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë;

6) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, me gjatësi deri në 60 cm;

7) armët e zjarrit të gjata, me përsëritje, që nuk janë përfshirë në pikën 6 të këtij paragrafi;

8) armët e gjata të zjarrit për një qitje, me një ose më shumë tyta të vjaskuara;

9) armët e gjata, gjysëmautomatike që nuk janë përfshirë në pikën 4 deri 6 të këtij paragrafi;

10) armët e shkurtra të zjarrit për një qitje, me gjatësi të përgjithshme mbi 28 cm;

11) armët e gjata të zjarrit me një shkrepje, me një ose më shumë tyta të pavjaskuara;

12) armët antike;

13) armët e gjata të zjarrit për një qitje, me kombinim grykash të pavjaskuara ose të vjaskuara;

14) armët e zjarrit gjysëmautomatike të projektuara për qëllime civile, të cilat janë ngjashme me armën automatike të zjarrit, por që nuk janë përfshirë në pikën 9 të këtij paragrafi.

Armë të kategorisë C janë:

1) armët me gaz;

2) riprodhimet e armëve të zjarrit në të cilat nuk aplikohet rimbushje e vetme;

3) mortajat;

4) armët pneumatike energjia kinetike e të cilave është më e madhe se 10,5 J ose shpejtësia e predhës është më e madhe se 250m/s ose me kalibër më të madh se 4,5 mm;

5) armët me hark fuqia e së cilës është më e madhe se 450 N.

Armë të kategorisë D janë:

1) armët pneumatike me energji kinetike që arrin deri në 10,5 J ose shpejtësi predhe deri në 250 m/s dhe kalibër deri në 4,5 mm;

2) armët me hark me fuqi më e vogël se 450 N;

3) paralizuesit elektrikë;

4) spërkatësit;

5) armët e ftohta.

Pjesët kryesore të armëve, kur janë objekte të çmontueshme, duke përfshirë edhe kategorinë e armëve të zjarrit në të cilën janë montuar ose do të montohen.

Neni 5

Ndalohet blerja, mbajtja, dhe marrja e armëve dhe municioneve të kategorisë A dhe armëve të ftohta qëllimi i të cilave është sulmi ose shkaktimi i plagosjeve, si dhe i objekteve të përshtatshme për shkaktim lëndimesh kur mbahen në vende publike dhe kur mënyra dhe rrethanat e mbajtjes së tyre tregojnë se mbahen sikur do të përdroshin momentalisht për ngacmim, sulm ose shkaktim lëndimi.

Lejohet prokurimi, mbajtja, marrja dhe transporti i armëve dhe municioneve, armëve të kategorisë B për të cilat është dhënë dokumenti përkatës për armën, në përputhje me këtë ligj.

Lejohet prokurimi, mbajtja, marrja dhe transporti i armëve dhe municioneve, armëve të kategorisë C të cilat janë raportuar në përputhje me këtë ligj.

Lejohet blerja, mbajtja, marrja dhe transporti i armëve dhe municioneve të kategorisë D pa dokument për armën dhe raportim.

Neni 6

Në përmbajtje të këtij ligji nuk konsiderohet armë, arma dekorative, imitimet e armëve, arma e çaktivizuar përgjithmonë në bazë të këtij ligji, arma e projektuar për alarm, sinjalizim, shpëtim, arma që përdoret për qëllime industriale dhe teknike në qoftë se përdoret vetëm për këto qëllime, armët nënujore dhe objekte të tjera të cilat me fuqinë e sustës, gomës presionit ose gazit të ngjeshur, hedhin shigjetë ose harpë që përdoret ekskluzivisht në peshkim (pushkë nënujore), municioni për armë pneumatike dhe municioni i rremë.

Neni 7

Për procedurat që zhvillohen në bazë të këtij ligji, zbatohet ligji rregullues i procedurës administrative.

Neni 8

Në këtë ligj, shprehjet e përdorura përdoren në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe gjininë femërore.

Neni 9

shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e mëposhtme:

1) armë zjarri është çdo pajisje e cila, nën veprimin shtytës të gazeve të barutit, nxjerr përmes tytës plumb, sferë, saçme, shigjetë ose predha të tjera;

2) armë ushtarake dhe municion për këtë armë është arma dhe municioni i blerë në përputhje me dispozitat e veçanta, tregtimi i të cilave nga personat fizikë nuk lejohet ose është i kufizuar;

3) Lëndë plasëse janë të gjitha llojet e pajisjeve minuese-plasëse, në formën e bombave, minave, granatave dhe mjeteve të tjera të pajisura me lëndëve plasëse ose detonator, të cilat nën veprime të caktuara të jashtme ose të brendshme (peshja, goditja, lëvizja, fërkimi, reaksioni kimik, energjia elektrike etj.) çlirojnë energji dhe shkaktojnë shpërthimin e tyre;

4) armë e gjatë zjarri është çdo armë zjarri përveç armëve të shkurtra të zjarrit;

5) armë zjarri e shkurtër është arma tyta e të cilës nuk e kalon 30 cm ose gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk kalon 60 cm;

6) armë automatike është çdo armë zjarri e cila rimbushet automatikisht sa herë që shkrepet fisheku dhe mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

7) armë gjysëmautomatike është arma e zjarrit e cila rimbushet automatikisht sa herë që shkrepet fisheku dhe mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

8) armë zjarri me përsëritje është arma e zjarrit e cila, pas shkrepjes së plumbit, duhet të rimbushet manualisht nga karikatori apo nga cilindri;

9) armë zjarri me një të shtënë të vetme është arma pa karikator, e cila mbushet manualisht përpara çdo shkrepjeje, duke e futur fishekun në folenë e fishekut;

10) armë për vetëmbrojtje janë armët e zjarrit të shkurtra dhe të gjata të kalibrave të ndryshëm;

11) armë sportive është arma e zjarrit e kategorisë B, e cila përdoret në për qitje sportive, në përputhje me standardet ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave përcaktohet edhe lloji edhe kalibri i armës sportive;

12) armë gjuetie është arma e zjarrit e kategorisë B me anë të së cilës mund të gjuhen kafshë të egra në bazë të dispozitave për gjuetinë;

13) armë me gaz janë pistoletat, revolverët, pushkët dhe mjetet e tjera të cilat, nën presionin e energjisë së mbushjes së barutit ose të gazit të ngjeshur, përhapin në mënyrë të drejtuar substanca irrituese për neutralizimin e personave, të cilat kanë efekte afatshkurtra në shëndetin e njeriut;

14) riprodhim i armëve janë kopjet e armëve të gjata ose të shkurtra, të cilat nuk përdorin mbushje të vetme por mbushen nga gryka e tytës me barut të zi dhe ndizen me fitil, masat ose kapsollë;

15) Mortaja janë mjete dore ose të fiksuara të projektuara për të realizuar të shtëna me zhurmë, të cilat janë projektuar të tilla që të mos marrin një mbushje të vetme, por të mbushen nga gryka me sasinë e caktuar të barutit të zi dhe të ndizen me strall, masat ose kapsollë, dhe përmbajnë lëndë me peshë të vogël specifike;

16) Armë pneumatike janë lloje pushkësh, pistoletash, revolverësh dhe pajisjesh të tjera të cilat, nën forcën e presionit të ajrit ose të një gazi tjetër, nxjerrin nga tyta fishek, sferë, saçmë ose predhë tjetër;

17) Armë me hark ose me tojë janë harqet dhe mekanizmat e tjerë që funksionojnë nën shtypjen e fijos së shtrënguar, të cilat gjuajnë shigjetë apo predha të tjera;

18) Paralizues elektrik është pajisja e dorës e cila, nën veprimin e tensionit të lartë elektrik, neutralizon përkohësisht personin;

19) armë të ftohta janë tehet, kamat, shpatat, pinjallët, bajonetat dhe thikat me shkrepje me teh që funksionon nën presionin e lakut të tendosur, i cili del nga doreza pas shtypjes së butonit ose të levës, dorezat ose yjet metalikë të projektuara për t'u hedhur, pavarësisht gjatësisë së tehut të tyre ose të tehut të mprehtë të fshehur, bokserët dhe armët e tjera të fshehura, me tehe të fshehur (bastunët

armë, çadrat armë etj.). Armë të ftohta konsiderohen edhe objektet e përshtatura për të shkaktuar lëndim, kur mbahen në vende publike.

20) Armë për sinjalizim janë pistoleta, revolveri, pushka dhe pajisje të tjera të cilat, nën ndikimin e energjisë së mbushjes prej baruti ose të gazit të ngjeshur, përhapin në mënyrë të drejtuar ose ndezin mbushjen e synuar ekskluzivisht për shkaktim të shtënash zhurmuese dhe ndezje të raketave me dritë sinjalizuese;

21) Armë antike janë armët të cilat kanë vlera historike, armët të cilat janë pjesë përbërëse e veshjeve popullore, si dhe armët ushtarake e policore të hershme dhe të papërdorshme, armët që janë pjesë përbërëse të veshjeve festive të paradeve ushtarake dhe të policisë, armët e prodhuara përpara vitit 1870, si dhe armët që mbushen me barut të zi nga gryka e tytës dhe që ndizen me masat, fitil ose kapsollë.

22) armë dekorative është arma e cila është prodhuar për qëllime dekorative dhe që nuk mund të përdoret ose të kthehet në armë zjarri;

23) imitim arme është objekti i cili nga pamja e jashtme është i ngjashëm ose i njëjtë me armën, por nuk mund të përdoret ose të kthehet në armë zjarri;

24) municion është fisheku me mbushje të vetme me të cilin mbushet arma e zjarrit, i cili përfshin gëzhhojën, kapsollën, mbushjen e barutit dhe predhën. Nuk konsiderohet municion, municioni pa predhë, municioni për pajisje industriale, municioni për pajisje për vrasjen e bagëtisë, municioni për pajisjet lëshuese dhe sinjalizuese, si dhe komponentët e veçantë të fishekëve (gëzhojat, kapsolla, mbushja e barutit dhe predha);

25) municion manovër është municioni pa mbushje të ngjeshur dhe vdekjeprurëse, i cili shkakton efektin e të shtënës;

26) substanca të padëmshme të lejuara konsiderohen përbërjet kimike CN (klorocetofenon), CS (ortoklorbenzenmalon – dinitril) dhe OC (oleoresin capsicum) në përqendrime të lejuara;

27) roje sigurie është personi i cili merret me veprimet e ruajtjes fizike të personave dhe pronës, në bazë të ligjit të posaçëm;

28) tregtar armësh është personi juridik ose sipërmarrësi i cili nuk është ndërmjetës për armët, tregtia dhe biznesi i të cilit konsiston plotësisht ose pjesërisht në prodhimin, tregtinë, shkëmbimin, ndërmjetësimin midis pronarit të armëve dhe blerësit, dhënien në përdorim ose riprodhimin e armëve, pjesëve të armëve dhe municionit;

29) ndërmjetës në tregtinë e armëve është personi juridik ose sipërmarrësi i cili nuk është tregtar armësh, tregtia ose biznesi i të cilit konsiston plotësisht ose pjesërisht në prokurimin, shitjen ose kontraktimin për transferim të armëve midis prodhuesit dhe tregtarit të armëve.

II. DOKUMENTET PËR ARMËT

1. Llojet e dokumenteve

Neni 10

Dokumentet që miratohen në bazë të këtij ligji janë:

- 1) leja për blerje arme;
- 2) fleta e regjistrimit të armës për posedim, mbajtje dhe marrje arme;
- 3) leja për mbajtje arme;
- 4) leja për koleksion të armëve të vjetra;
- 5) leja për përdorim të armëve të zjarrit;
- 6) Karta evropiane e armës;
- 7) Dokumente të tjera për armët të lëshuara në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

Neni 11

Dokumentet sipas nenit 10 të këtij ligji miratohen nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët e brendshme (në vijim referuar si Ministria)

2. Leja për blerje arme

Neni 12

Leja për blerjen armëve të kategorisë B u lëshohet personave fizikë për qëllime vetëmbrojtjeje ose për posedim dhe mbajtje të armëve të gjuetisë dhe armëve sportive, në qoftë se plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji, në formatin e përshkruar.

Përveçse nga sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, leja për blerje armësh për qëllime gjuetie dhe sportive dhe për posedim dhe mbajtje arme i lëshohet personit fizik që disponon kartë të vlefshme regjistrimi për armët, për posedimin dhe mbajtjen e armëve për të njëjtin qëllim, si dhe të armëve që blen, në qoftë se janë plotësuar kushtet e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 3, 4 dhe 5 e këtij ligji.

Neni 13

Kërkesat e përgjithshme për lëshimin e lejes për shitje të armëve të kategorisë B personave fizikë janë:

- 1) personi ka arsye të justifikuara për blerjen e armatimeve;
- 2) ka mbushur moshën 18 vjeç;
- 3) nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër: rendit kushtetues dhe sigurisë së Malit të Zi, njerëzimit dhe vlerave të tjera të mbrojtura sipas të drejtës ndërkombëtare; jetës dhe trupit, sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës, si dhe vepra penale të cilat në vetvete përmbajnë elemente dhune dhe bëjnë pjesë në veprat penale kundër: pronës, lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, lirisë seksuale, martesës dhe familjes, drejtësisë, rendit publik dhe paqes, detyrave të shërbimit, ushtrisë, mjedisit jetësor që lidhet me vrasjen dhe mundimin e kafshëve ose në qoftë se për këto vepra penale ka nisur procedim penal;

- 4) nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje të cilat tregojnë se armët mund të keqpërdoren, veçanërisht për shkelje që përfshijnë elemente të dhunës në familje, pra që nuk është nisur procedim për këto shkelje;

- 5) nuk ka rrethana të tjera të cilat tregojnë që armët mund të keqpërdoren dhe veçanërisht: për shkelje që përfshijnë abuzimin me alkoolin, drogat ose substanca të tjera psikoaktive, marrëdhënie të çrregulluara familjare, konflikte me ambientin, sjellje agresive, si dhe çrregullime të tjera në sjellje, shkelje disiplinore të dispozitave për gjuetinë ose qitjen sportive;

kërkesat e veçanta për lëshimin e lejes për blerje armësh personi publik janë:

- 1) të jetë aftë nga ana shëndetësore për të poseduar dhe mbajtur armë;
- 2) të disponojë njohuri dhe aftësi teknike për përdorim, ruajtje dhe mbajtje të rregullt të armës.

Neni 14

Personi fizik ka arsye të justifikuara për prokurim armësh të kategorisë B kur bëhet fjalë për prokurim armësh për qëllime vetëmbrojtjeje, përkatësisht të armëve për gjueti dhe atyre sportive.

Neni 15

Për të konstatuar ekzistencën e rrethanave që tregojnë se armët mund të keqpërdoren sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 5 të këtij ligji, punonjësi i policisë është i autorizuar që të kërkojë dhe të grumbullojë të dhëna dhe shpjegime rreth aplikantit për lëshim të lejes për blerje arme dhe të hartojë një procesverbal zyrtar për të dhënat e mbledhura, i cili i dërgohet ministrisë.

Procesverbal i zyrtar duhet të përmbajë të dhëna të detajuara të konkretizuara me fakte të cilat konfirmojnë në mënyrë të padiskutueshme përmbajtjen e procesverbalit.

Neni 16

Mbi ekzistencën e kushteve sipas nenit 13 paragrafi 3 pika 1 të këtij ligji, aplikanti që ka bërë kërkesë dëshmon me anë të vërtetimit mbi aftësinë shëndetësore të lëshuar nga institucioni shëndetësor i caktuar në bazë të dispozitave për mbrojtjen shëndetësore, me afat vlefshmërie prej pesë vjetësh.

Institucioni shëndetësor ka detyrimin që sapo të vihet në dijeni të ndryshimit të gjendjes shëndetësore të personit të cilit i ka lëshuar vërtetim të aftësitë shëndetësore për ruajtje dhe mbajtje arme, të informojë menjëherë Ministrinë.

Neni 17

Aplikanti vërtetohet ekzistencën e kushteve sipas nenit 13 paragrafi 2 pika 2 të këtij ligji, si më poshtë:

1) për armët për qëllime vetëmbrojtje të kategorisë B – me anë të një vërtetimi mjekësor të aftësisë për të përdorim të rregullt të armëve, të lëshuar nga personi juridik ose sipërmarrësi sipas nenit 99 të këtij ligji;

2) për armët e gjuetisë të kategorisë B – me anë të vërtetimit të kalimit me sukses të provimit të gjuetisë dhe të vërtetimit nga organizata e gjuetarëve që cilëson se personi është anëtar aktiv i saj;

3) për armët sportive të kategorisë B – me anë të vërtetimit të organizatës së qitjes sportive që dëshmon se personi është anëtar aktiv i saj.

Për armët sipas paragrafit 1 pika 1 të këtij neni, përmbushja e kërkesave të veçanta sipas sipas nenit 13 paragrafi 2 të këtij ligji për punonjësit i policisë, personelin ushtarak profesionist dhe çdo person tjetër që në bazë të dispozitave të veçanta është i autorizuar që të zotërojë dhe mbajë armë, vërtetohet nga organi ku punon aplikanti.

për armët sipas paragrafit 1 pika 1 të këtij neni, personi fizik i cili disponon kartë të vlefshme të regjistrimit të armës, nuk bashkëlidh dëshmi për përmbushjen e kushteve sipas nenit 13 paragrafi 2 pika 2 të këtij ligji.

Për armët sipas paragrafit 1 pikat 2 dhe 3 të këtij neni, personi fizik i cili disponon kartë të vlefshme të regjistrimit të armës, nuk bashkëlidh dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kushteve nga neni 13 paragrafi 2 pika 2 e këtij ligji.

Neni 18

Lejet për blerje të armëve të kategorisë B, sipas formularit të përshkruar, u lëshohen personave juridik nëse ata:

1) kanë arsye të justifikuara për blerjen e armëve;

2) personi përgjegjës në personin juridik plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji;

3) disponon ambiente për vendosje dhe ruajtje të sigurt të armëve.

Arsye të justifikuara për blerje armësh sipas paragrafit 1 pika 1 të këtij neni ka personi juridik i cili është i regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të vijim: gjueti, mbarështim të kafshëve të egra, qitje sportive, ofrim të shërbimeve të qitjes sportive-rekreative dhe të aftësisë të qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve në poligonet civile të qitjes, aftësisë mbi zotërimin dhe mbajtjen e armës dhe për kryerjen e veprimtarive të mbrojtjes fizike të personave dhe pronës, kërkim shkencor për të cilin nevojitet arma, mbledhje të të dhënave shkencore mbi llojet e kafshëve, xhirim filmi, paraqitja e shfaqjeve teatrale ose zhvillim të lojërave tradicionale me kuaj dhe të shfaqjeve të tjera që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore e të ngjashme, si dhe muzeale.

Përmbajtja dhe forma e formularit sipas paragrafi 1 të këtij neni dhe nenit 12 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet nga Ministria.

Neni 19

Personat juridikë që merren me xhirim filmash, paraqitje shfaqjesh teatrale ose organizim të lojërave tradicionale me kuaj dhe shfaqjesh të tjera që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore, mund të blejnë, zotërojnë dhe përdorin armë të ftohta dhe armë të kategorisë A, B dhe C të përshtatura për të shkrepur vetëm municion të rremë.

Neni 20

Kërkesa për lëshim të lejeve për blerje arme paraqitet pranë Ministrisë në vendbanimin ose vendqëndrimin e aplikantit, sipas formularit të përshkruar.

Përmbajtja e formularit sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet nga Ministria.

Neni 21

Në dorëzimin e kërkesës për lëshim të lejes për blerje arme, aplikanti nuk dorëzon dëshmi të përmbushjes së kërkesave të veçanta të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 2 të këtij ligji.

Kur Ministria konstaton se aplikanti plotëson kushtet e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 të këtij neni, ajo i kërkon aplikantit që brenda 15 ditëve të dorëzojë dëshmi që vërtetojnë se janë përmbushur kushtet e veçanta të përcaktuara në nenin neni 13 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 22

Lejet për blerje armësh për personat fizikë ose juridikë lëshohen me afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh nga data e lëshimit.

Afati i lejeve për blerje armësh, të cilat nuk janë shfrytëzuar brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të zgjatet shtyhet për gjashtë muajt vijues, me kërkesë të personit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Lejet për blerje arme që nuk janë shfrytëzuar në afatin sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, i kthehen organit që i ka lëshuar ato, brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë.

3. Karta e regjistrimit të armës dhe leja për zotërim arme

Neni 23

Për armët e blera mbi bazën e lejes për blerje armësh, personi fizik paraqet një kërkesë për lëshim të kartës së regjistrimit të armëve për zotërim dhe mbajtje të armëve, ndërsa personi juridik paraqet një kërkesë për lëshim të lejes për mbajtje arme pranë Ministrisë në vendin e banimit ose të qëndrimit, pra në vendin e aplikantit, brenda tetë ditësh nga data e blerjes së armëve.

Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni dorëzohet me anë të formularit të përcaktuar.

Karta e regjistrimit të armëve për mbajtje të armëve të kategorisë B u lëshohet personave fizikë për armë për qëllime vetëmbrojtjeje, karta e regjistrimit të armëve për zotërim dhe mbajtje armësh për qëllime gjuetie dhe sportive dhe leja për zotërim armësh u lëshohet personave juridikë, me anë të formularit të përshkruar.

Karta e regjistrimit të armëve për zotërimin dhe mbajtjen e armëve lëshohet me afat vlefshmërie prej dhjetë vjetësh.

Karta e regjistrimit të armëve për zotërim dhe mbajtje armësh dhe leja për mbajtje arme lëshohen me afat vlefshmërie prej dhjetë vjetësh.

Për armët e gjuetisë ose sportive mund të lëshohet kartë regjistrimi të armëve për zotërim dhe mbajtje armësh për përdorues të përbashkët, me afat vlefshmërie prej dhjetë vjetësh.

Përmbajtja e formularit sipas paragrafit 2, 3 dhe 6 të këtij neni përcaktohet nga Ministria.

Neni 24

Personi fizik ose juridik të cilit i ka skaduar afati i vlefshmërisë i dokumentit të armës sipas nenit 23 paragrafi 4 dhe 5 të këtij ligji, duhet të paraqesë kërkesë për lëshim të një dokumenti arme të ri, brenda 30 ditëve nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë, me anë të formularit të përshkruar.

Personi që nuk vepron në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, njoftohet nga Ministria që të dorëzojë një kërkesë për lëshim dokumenti për armën brenda afatit të përcaktuar, i cili mund të zgjatet me kërkesë të personit të dorëzuar përpara skadimit të afatit të caktuar, nëse ekzistojnë shkaqe të justifikueshme.

Kur Ministria konstaton se aplikanti plotëson kushtet e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, ajo i kërkon atij që brenda 15 ditësh të dorëzojë dëshmi të plotësimit të kushteve të veçanta sipas paragrafit 13 paragrafi 2 pika 1 të këtij ligji.

Në rastet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, personit fizik i lëshohet dokument për armën sipas nenit 23 paragrafi 3 të këtij ligji në qoftë se konstatohet se janë plotësuar kushtet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 3, 4 dhe 5 dhe paragrafit 2 pika 1 të këtij ligji, ndërsa personit juridik i lëshohet leje për mbajtje arme në qoftë se konstatohet se janë përmbushur kushtet sipas nenit 18 të këtij ligji.

Në qoftë se pronari nuk vepron në mënyrën e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, me armën do të veprohet siç përcaktohet në nenin 48 dhe 51 të këtij ligji.

4 Leja për koleksionim të armëve të vjetra

Neni 25

Leja për koleksionim të armëve të vjetra i lëshohet personit fizik dhe juridik me kërkesë të tij.

Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni depozitohet pranë Ministrisë në vendin e banimit ose të qëndrimit, pra në vendin e aplikantit, me anë të formularit të përcaktuar.

Personi fizik dhe juridik mund të koleksionojë armë të vjetra në qoftë se disponon ambiente për vendosjen dhe ruajtjen e sigurt të armëve të koleksionuara.

Leja për koleksionim të armëve të vjetra i lëshohet personit fizik në qoftë se plotëson kushtet e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 2, 3, 4 dhe 5 dhe paragrafi 2 pika 1 të këtij ligji dhe personit juridik që plotëson kushtet sipas nenit 18 paragrafi 1 pika 3 të këtij ligji, me kusht që personi përgjegjës të përmbushë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 pikat 3, 4 dhe 5 dhe paragrafi 2 pika 1 të këtij ligji.

Leja për koleksionim të armëve të vjetra lëshohet me afat të gjatë vlefshmërie.

Përmbajtja e formularit sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet nga Ministria.

Neni 26

Armët që mbahen në bazë të lejes për koleksionim të armëve të vjetra nuk duhet të mbartet apo përdoret dhe për të as nuk mund të blihet, zotërohet ose të prodhohet municion.

Armët e koleksionuara në bazë të lejes sipas paragrafit 1 të këtij neni mund t'u shiten ose transferohen vetëm personave që kanë marrë leje për koleksionim të armëve të vjetra.

Armët e zjarrit që janë nxjerrë jashtë përdorimit nuk duhet të riaktivizohet. Si përjashtim, muzetë, përveç armëve të vjetra, mund të koleksionojnë edhe armë të kategorisë A sipas nenit 4 paragrafi 2 pikat 2, 3 dhe 6 të këtij ligji, të cilat nuk prodhohen më dhe nuk përdoren më nga ushtria ose policia, me kusht që të jetë çaktivizuar përgjithmonë.

Muzetë mund të koleksionojnë armë të kategorisë A sipas nenit 4 paragrafi 2 pikat 1, 4, 5 dhe 7 të këtij ligji dhe municionin për këto armë, me kusht që ato të jenë çaktivizuar përgjithmonë.

5. Armët që duhet të raportohen

Neni 27

Personat fizikë mbi 18 vjeç dhe personat juridikë mund të blejnë dhe zotërojnë armë të kategorisë C, pa leje nga Ministria.

Personat sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilët blejnë armë të kategorisë C, duhet t'ia raportojnë ato Ministrisë, brenda tetë ditësh nga data e blerjes.

Ministria lëshon konfirmim për raportimin e armëve të blera, në qoftë se personi fizik ose personi përgjegjës në personin juridik plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 13 paragrafi 1 pikat 3 dhe 4 të këtij ligji.

Tregtarët e armëve njofton ministrinë për shitjen e armëve të kategorisë C brenda tetë ditësh nga data e shitjes së tyre.

6. Të drejtat dhe detyrimet që lindin nga dokumentet për armët

Neni 28

Armët e kategorisë B nuk duhet të mbahen ose të transportohet pa dokument të vlefshëm të tyre.

Mbajtja e armëve nënkupton veprimin e mbajtjes së armëve të mbushura dhe gati për përdorim të menjëhershëm.

Transport i armëve nënkupton transportin nga njëri vend në tjetri të armëve për të cilat është lëshuar dokumenti për armët, vetëm bosh dhe që nuk janë gati për përdorim, të mbyllura në kutitë, arkat dhe këllëfët përkatës të ndara nga municioni, në rast ndryshimi të vendbanimit ose të vendqëndrimit të pronarit të armëve ose në rast riparimi ose modifikimi të tyre, daljes për gjueti ose në poligone qitjeje, pjesëmarrje në konkurse sportive ose daljes në vende të tjera të caktuara për ushtrime qitjeje dhe në situata të tjera të justifikuara.

Neni 29

Armët dhe municioni mund t'u shiten ose dorëzohen vetëm personave fizikë ose juridikë të pajisur me leje të vlefshme për blerje armësh ose me karta regjistrimi të armëve për zotërim armësh ose karta regjistrimi të armëve për zotërim dhe mbajtje armësh ose lejë për mbajtje arme.

Armët dhe municioni mund t'u shiten personave sipas paragrafit 1 të këtij ligji neni, drejtpërdrejt ose nëpërmjet tregtarit të armëve.

Tregtari i armëve, në përputhje me këtë ligj, është i detyruar që për shitjen e armëve personave fizikë dhe juridikë, në bazë të lejes për blerje të armëve, të njoftojë Ministrinë brenda tetë ditësh nga data e shitjes së tyre.

Personi fizik dhe juridik i cili shet armë për të cilat është lëshuar dokumenti i armës sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të njoftojë Ministrinë për shitjen e armëve personave fizikë ose juridikë, në bazë të lejes për blerje arme, brenda tetë ditësh nga data e shitjes së tyre, me qëllim çregjistrimin e tyre.

Neni 30

Personat fizikë që posedojnë armë në bazë të dokumentit të vlefshëm për armët sipas nenit 23 paragrafi 3 të këtij ligji ose armë sipas nenit 27 paragrafi 3 të këtij ligji, mund të shkëmbejë armët e të njëjtës kategori.

Në rastin e shkëmbimit të armët sipas paragrafit 1 të këtij neni, personat fizikë duhet të njoftojnë Ministrinë për shkëmbimin në fjalë dhe, në rastin e armëve të kategorisë B, të paraqesin kërkesë për lëshim të kartës për regjistrim të armëve për mbajtje arme; për armët e kategorisë C, duhet të njoftojnë Ministrinë për lëshim të certifikatës sipas nenit 27 paragrafi 3 i këtij ligji, brenda tetë ditësh nga data e kryerjes së shkëmbimit.

Neni 31

Pronari i armës që posedon armë për të cilën është lëshuar dokument për armën sipas nenit 23 paragrafi 3 dhe nenit 27 paragrafi 3 të këtij neni, mund t'i çaktivizojnë ato te një shoqëri tregtare ose sipërmarrës i cili ka leje për riparimin dhe modifikimin e armëve.

Çaktivizimi i armës së zjarrit nënkupton çaktivizimin e të gjitha pjesëve kryesore të saj në mënyrë të tillë që arma të mos aktivizohet duke hequr, zëvendësuar ose ndërruar pjesët.

Shpenzimet për çaktivizimin e armëve mbulohen nga pronari i armës.

Pronari i armës është i detyruar që të njoftojë Ministrinë për çaktivizimin e përhershëm të armës brenda tetë ditësh nga data e çaktivizimit, duke bashkëlidhur vërtetimin sipas nenit 88 paragrafi 3 të këtij ligji, me qëllim çregjistrimin e saj.

Mënyra e detajuar të çaktivizimit të armës përcaktohet nga Ministria.

III. ADMINISTRIMI I ARMËVE DHE MUNICIONIT

1. Rregulla të përgjithshme

Neni 32

Armët dhe municioni duhet të administrohet me kujdes të veçantë.

Vëmendje e veçantë në administrimin e armëve dhe municionit konsiderohet ruajtja e rregullt, përdorimi profesional, mbajtja sipas rregullave, transporti dhe mbajtja e armatimit në gjendje të rregullt.

Neni 33

Është e ndaluar mbajtja e armëve na vende publike.

Të gjithë janë të detyruar që të respektojnë rregullat e ndalimit të publikuara në lidhje me futjen e armëve në ambiente të caktuara.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, personi fizik të cilit i është dhënë karta e regjistrimit të armët për mbajtje arme mund ta mbajë armën vetëm për përdorim në terrene gjuetie, në poligone qitjeje, në konkurse sportive ose në vende të tjera të caktuara për aktivitetet e qitjes.

Vendi i caktuar për kryerjen e aktivitetit të qitjes është ambienti i cili për nga pozicioni dhe masat e marra të sigurisë nuk mund të kërcënojë sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

Personi fizik të cilit i është lëshuar karta e regjistrimit të armës për mbajtje arme, mund ta transportojë atë vetëm për qëllime riparimi, modifikimi ose në rastin e ndryshimit të vendbanimit, ose vetëm për përdorim në poligone qitjeje.

Personi fizik nuk duhet ta mbajë dhe përdorë armën kur është nën ndikimin e alkoolit, drogës ose të substancave të tjera psikoaktive, ose kur është në gjendje të tillë që nuk mund të kuptojë rëndësinë e veprimeve tij ose nuk mund t'i kontrollojë ato.

Në vende publike, armët e kategorisë B, C dhe D nuk duhet jenë të dukshme për personat e tjerë dhe as nuk duhet të mbahen në mënyrë të tillë që t'i shqetësojnë ata.

Përveç rastit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, personeli i sigurisë mund të mbajë armë gjatë kryerjes së detyrave të ruajtjes fizike, në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e sigurisë fizike të personave dhe pronës.

2. Ruajtja e armëve dhe municionit

Neni 34

Armët dhe municioni duhet të ruhen në vende të paaksesueshme nga persona të cilët nuk janë të paautorizuar për mbajtjen e tyre dhe veçanërisht nga personat e mitur; ato duhet të mbahen të kyçura dhe të ndara në armatura metalike, kasa të sigurta apo në vende të ngjashme, ose në mënyra të tjera të sigurta.

Armët dhe municioni duhet të ruhen në ambientin e banimit ose në ambiente të tjera të pronarit të armëve në vendin e banimit ose të qëndrimit të tij, ose në adresën e regjistruar të personit juridik.

Neni 35

Pronari i armëve dhe municionit i cili ndryshon përkohësisht vendbanimin dhe vendqëndrimin e tij dhe armët dhe municionin që posedon sipas këtij ligji në bazë të kartës së regjistrimit të tyre nuk i merr me vete, mund t'ia dorëzojë ato në ruajtje një personi që ka kartë regjistrimi armësh për zotërim ose mbajtje armësh ose një tregtari të autorizuar armësh.

3. Përdorimi i armëve

Neni 36

Pronari i armëve duhet t'i mbajë ato në gjendje të rregullt dhe t'i administrojë siç duhet.

Është i ndaluar përdorimi i armës në vende publike ose në një vend tjetër ku mund të kërcënojë sigurinë e qytetarëve.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, arma e gjuetisë dhe sportive mund të përdoret në terrene gjuetie në përputhje me dispozitat për gjuetinë, si dhe në poligone qitjeje ose në vende të tjera të caktuar për ushtrime qitjeje, ndërsa arma pneumatike dhe me hark mund të përdoret në ambiente publike dhe private në mënyrë të tillë që të mos kërcënojë sigurinë e personave dhe të pronës.

Në rastet e parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni, armët sportive mund të përdoren nga persona të mitur të moshës 14 vjeç lart dhe armët pneumatike dhe me hark mund të përdoren nga persona të mitur të moshës 11 vjeç e lart, nën mbikëqyrjen e një personi që përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, dhënia e armëve për përdorim personave të mitur është e ndaluar.

Armët e gjuetisë dhe armët sportive të gjata dhe të shkurtra, si dhe municioni për këto armë, transportohen në përputhje me nenin 28 paragrafi 3 i këtij ligji.

Neni 37

Personi juridik që posedon armë në bazë të lejes për zotërim arme, mund t'ia japë ato për përdorim personave personave që përmbushin kushtet e parashikuara në këtë ligj, për kryerjen e detyrave për të cilat janë regjistruar.

Punonjësit e personave juridikë të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe anëtarët e organizatave sportive, të qitjes dhe të gjuetarëve, të cilët përdorin armët e këtyre personave juridikë ose organizata, duhet të kenë certifikata të lëshuara prej këtyre të fundit për zotërim, mbajtje dhe transport të armëve dhe municioneve në fjalë.

Përmbajtja e certifikatës sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet nga Ministria.

Neni 38

Personi fizik dhe juridik mund t'u huazojnë armë sportive, gjuetie dhe antike personave të cilët disponojnë kartë regjistrimi arme për këto lloj armësh ose leje për mbajtje arme, leje për blerje të këtyre lloj armësh ose leje për koleksionim të armëve antike, si dhe shtetasve të huaj të pajisur me leje gjuetie të lëshuar nga organizata e gjuetisë në përputhje me ligjin e posaçëm, me kushtin që shtetasi i

huaj të disponojë lejë për mbajtje të këtyre armëve në përputhje me rregulloret e shtetit të vendbanimit të tyre.

Armët mund t'u huazohen shtetasve të huaj në poligone civile qitjeje dhe për qëllime të pjesëmarrjes në konkurse sportive, me kushtin që ata të kenë lejë për mbajtje të këtyre lloj armësh në përputhje me rregulloret e shtetit të vendbanimit të tyre.

4. Humbja, vjedhja dhe gjetja e armëve, municionit dhe dokumenteve për armët

Neni 39

Personi fizik dhe juridik i cili posedon armë në bazë të lejes për blerje arme, kartës së regjistrimit të armës për mbajtje arme ose kartës së regjistrimit të armës për zotërim dhe mbajtje arme, lejes për mbajtje arme ose lejes për koleksionim të armëve të vjetra, duhet ta denoncojë pa vonesë humbjen ose vjedhjen e armës ose të municionit.

Denoncimi sipas paragrafit 1 bëhet në policinë e vendit ku ka ndodhur ngjarja ose të njoftimit për humbjen ose vjedhjen e armës dhe municionit.

Policia njofton Ministrinë për denoncimin sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 40

Personi i cili gjen armë ose municion ose ka informacion për armë ose municion të fshehur, duhet të njoftojë për këtë policinë.

Policia njofton Ministrinë për denoncimin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Ndryshimi i të dhënave personale të pronarit të armëve

Neni 41

Në rast se personi fizik ose personi juridik që posedon armë në bazë të dokumentit për armë, ndryshon të dhënat personale (emrin personal, vendbanimin, vendqëndrimin ose adresën e regjistruar), duhet të bëjë kërkesë për lëshim dokumenti për armën me këto të dhëna të ndryshuara brenda 15 ditësh nga data e ndryshimit.

6. Procedura në rast vdekje të pronarit të armës

Neni 42

Në rast vdekje të pronarit të armës, një person i rritur i familjes së tij, përfaqësuesi ligjor, kujdestari, një person i cili ka jetuar me të në të njëjtën banesë ose tek i cili ndodhej arma në momentin e vdekjes, duhet të njoftojë Ministrinë sapo të mësojë ekzistencën e tyre, me qëllim dorëzimin e armës dhe municionit.

Ministria lëshon vërtetim për armën dhe municionin e dorëzuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Personi që ka trashëguar armën (në vijim referuar si: Trashëgimtari), brenda 60 ditëve nga data e marrjes së vendimit të formës së prerë për trashëgiminë, duhet:

- 1) ta dorëzojë armën;
- 2) të bëjë kërkesë për lëshim të kartës për regjistrim të armës për qëllime zotërim ose për zotërimi dhe mbajtje të armës;
- 3) çaktivizojë dhe të mirëmbajë atë, ose
- 4) t'ia dorëzojë armën të shtetit, kundrejt asnjë kompensimi.

Përveç rastit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, armët dhe municioni i trashëgimtarëve që nuk janë në moshë madhore ruhen nga Ministria deri sa ai të mbushë 18 vjeç.

Trashëgimtari i armës i cili ka mbushur 18 vjeç duhet të veprojë veprojë me armën në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 43

Trashëgimtari i armës i cili e shet armën ka detyrimin që ta çregjistrojë atë në Ministri, brenda tetë ditësh nga data e shitjes.

Neni 44

Trashëgimtarit të armës i cili dorëzon kërkesë sipas nenit 42 paragrafi 3 pika 2 e këtij ligji, Ministria i lëshon kartën për regjistrim arme për qëllime të mbajtjes së saj në qoftë se plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 13 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 1 e këtij ligji, ose kartë për regjistrim arme për zotërim dhe mbajtje arme, në qoftë se plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji.

Neni 45

Armën që trashëgimtari dëshiron ta mbajë si kujtim duhet ta çaktivizojë në mënyrë të përhershme, në përputhje me këtë ligj.

Trashëgimtari i armës e çregjistron armën e çaktivizuar në mënyrë të përhershme brenda tetë ditësh nga data e çaktivizimit dhe i dorëzon Ministrisë një vërtetim sipas nenit 88 paragrafi 3 i këtij ligji.

Neni 46

Armën të cilën trashëgimtari ia dorëzon shtetit kundrejt asnjë kompensimi çregjistrohen zyrtarisht.

Neni 47

Në qoftë se trashëgimtari nuk vepron në përputhje me nenin 42 paragrafi 3 të këtij ligji brenda 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për trashëgiminë ose i është refuzuar kërkesa për lëshim dokumenti për armën sipas nenit 44 të këtij ligji, me armën dhe municionin veprohet në përputhje me nenin 52 dhe 53 të këtij ligji.

IV. KONFISKIMI I ARMËS, MUNICIONIT DHE DOKUMENTIT TË ARMËS

Neni 48

Ministria i konfiskon armën, municionin dhe dokumentin e armës personit fizik që nuk përmbush më ndonjë nga kushtet e nenit 13 paragrafi 1 pika 1, 3, 4 dhe 5 dhe paragrafi 2 pika 1 e këtij ligji.

Përveç paragrafit 1 të këtij neni, në rast se nuk kushtet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 1 e këtij ligji nuk përmbushen më, personit fizik mund t'i konfiskohet karta e regjistrimit të armës për zotërim dhe mbajtje arme dhe t'i lëshohet karta për regjistrim arme për mbajtje të armës.

Ministria konfiskon armën dhe dokumentin e armës që është lëshuar për armën në fjalë nëse konstatohet se ajo është teknikisht e parregullt dhe nuk mund të rregullohet për përdorim të sigurt, si edhe armën dhe dokumentin e armës sipas nenit 24 paragrafi 5 të këtij ligji.

Ministria konfiskon armën e kategorisë C për të cilën është lëshuar vërtetim për armën e raportuar nga person fizik, kur personi nuk përmbush më kushtet e përcaktuara në nenin 13 paragrafi 1 pika 3 dhe 4 e këtij ligji.

Neni 49

Ministria ia konfiskon personit juridik armën, municionin, lejen për prokurim arme, lejen për koleksionim të armëve të vjetra dhe lejen për mbajtje arme nëse ai nuk përmbush disa nga kushtet e nenit 18 paragrafi 1 i këtij ligji.

Vendimi për konfiskim të armëve, municionit dhe dokumentit të armëve sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe nenit 48 të këtij ligji, miratohet nga Ministria.

Neni 50

Në qoftë se konstatohet se ekzistojnë rrethana të cilat tregojnë se arma mund të keqpërdoret, veçanërisht për shkak të konsumit të alkoolit, drogës ose të substancave të tjera psikoaktive ose të marrëdhënieve të destabilizuara familjare, arma, municioni dhe dokumenti i armës sekuestrohen menjëherë dhe para përmbjlljes së procedimit penal, procedimit për kundërvajtje, ose procedurave administrative, deri në përfundimin e këtij procesi, për ndërmarrjen e masave parandaluese për qëllime të mbrojtjes nga dhuna në familje ose të mbrojtjes së rendit publik, të cilat duhet të

ndërmerren pa vonesë, ndërsa faktet në të cilat bazohet vendimi për sekuestrimin e armës janë konfirmuar ose të paktën janë bërë të besueshme.

Arma dhe municioni i sekuestruar sipas paragrafit 1 të këtij neni ruhen në Ministri.

Neni 51

Pronari mund t'ia shesë ose dhurojë armën e sekuestruar dhe municionin personit fizik ose juridik që përmbush kushtet e parashikuara në këtë ligj, brenda gjashtë muajsh pas marrjes së vendimit të formës së prerë për sekuestrimin e armës dhe municionit.

Në qoftë se pronari i armës dhe i municionit të sekuestruar nuk e shet armën dhe municionin brenda afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria ia jep ato tregtarit të armëve për shitje.

Armët dhe municioni sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të ekspozohen për shitje jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së dorëzimit të tyre tregtarit të armëve.

Për armën dhe municionin e shitur, pronarit i takon kompensim në vlerën për të cilën ka rënë dakord me tregtarin e armëve.

Në qoftë se tregtari i armëve nuk e shet armën dhe municionin brenda afatit sipas paragrafit 3 të këtij neni, ai ia kthen Ministrisë brenda tetë ditësh.

Neni 52

Armët dhe municioni i sekuestruar në përputhje me këtë ligj, të cilat nuk do të shiten brenda një viti nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit për sekuestrim, pronari i armës mund t'i çaktivizojë dhe mirëmbajë si kujtim ose t'ia shtetit.

Arma dhe municioni i sekuestruar sipas një procesi përfundimtar të formës së prerë penal, kundërvajtës ose administrativ, si dhe arma dhe municioni i dorëzuar ose i gjetur, i vihen në dispozicion Ministrisë.

Mënyra e vënies në dispozicion të armës dhe municionit sipas paragrafit 2 të këtij neni, përcaktohet nga Komisioni, i cili ngrihet nga ministri i punëve të brendshme.

Në rastin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, pronarit të armës dhe të municionit të sekuestruar, të dorëzuar ose të gjetur, nuk i takon kompensim.

Mënyra e vënies në dispozicion të armës dhe municionit sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet nga Ministria.

Neni 53

Arma e sekuestruar në përputhje me këtë ligj vendoset dhe ruhet në mënyrën e parashikuar për të parandaluar dëmtimet që mund të shkaktojnë uljen e vlerës së armës.

V. FUTJA DHE NXJERRJA E ARMËVE DHE MUNICIONIT PËRMES KUFIRIT SHTETËROR

Neni 54

Shtetasit malazezë mund të kalojnë përmes kufirit shtetëror, pa njoftim paraprak, armë dhe municione që mund të blihen, zotërohen, mbahen dhe transportohen në përputhje me këtë ligj.

Shtetasit e huaj mund të fusin armët sipas paragrafit 1 të këtij neni përmes kufirit shtetëror për qëllime gjuetie ose pjesëmarrje në konkurse sportive, pa njoftim paraprak.

Kur një shtetas malazez ose i huaji transporton nëpërmjet kufirit shtetëror armë ose municion për qëllime gjuetie ose pjesëmarrje në konkurse sportive, armët dhe municioni nuk mund të shiten.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshje ndërkombëtare, armët dhe municioni mund të transportohet nëpërmjet kufirit shtetëror vetëm në pikat kufitare të transportit ndërkombëtar.

Neni 55

Kur kalojnë kufirin shtetëror, shtetasit malazezë dhe të huaj duhet t'ia deklarojnë armët dhe municionin që synojnë të kalojnë nëpërmjet kufirit shtetëror policisë kufitare dhe të bashkëlidhin dokumentet e armëve si provë për qëllimin e kalimit të tyre (ftesën, njoftimin nga organizatorët e aktivitetit të gjuetisë dhe të konkursit sportiv ose lejet për blerjen e armëve dhe të municionit).

Neni 56

Shtetasit malazezë dhe personat juridikë me seli në Mal të Zi mund të futin në territorin e Malit të Zi armë të blera për nevojat e veta, në bazë të lejes për blerje arme dhe lejes së organit të administratës shtetërore përgjegjës për tregtinë e jashtme.

Për lejen sipas paragrafit 1 të këtij neni, policia kufitare regjistron hyrjen e armës në territorin e vendit dhe njofton për këtë organin doganor kompetent dhe Ministrinë.

Armët dhe municionet të cilat, në përputhje me këtë ligj, mund të blihen pa leje, lejohen që të futen në Mal të Zi.

Kur futen armë dhe municione sipas paragrafit 3 të këtij neni, policia kufitare konfirmon hyrjen e tyre me anë të faturës ose të ndonjë dëshmie tjetër përkatëse që vërteton blerjen e armëve dhe të municionit dhe njofton për këtë organin doganor dhe Ministrinë.

Pronari i armëve sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda tetë ditësh nga futja e armëve në Malin e Zi, duhet të depozitojë pranë Ministrisë një kërkesë për lëshim të kartë për regjistrimin e armëve për qëllime të zotërimit ose kartë për regjistrimin e armëve për qëllime të zotërimit dhe mbajtjes së tyre, ose për lejë për mbajtje arme.

Në qoftë se për armët dhe municionin sipas paragrafit 1 të këtij neni, shtetasi malazez me vendbanim në një shtet tjetër nuk zotëron leje për blerjen e armëve, ato sekuestrohen për kohësisht në momentin e futjes në territorin e Malit të Zi dhe i dërgohen Ministrisë në vendin e banimit ose në vendbanimin e fundit të tij përpara largimit në shtetin tjetër, me shpenzimet e shtetasit në fjalë.

Në qoftë se shtetasi malazez me vendbanim në shtet tjetër nuk bën kërkesë për lëshim të lejes për blerje arme ose nëse Ministria refuzon kërkesën për blerje arme, atij i caktohet një afat 30-ditor për kthimin e armëve dhe të municionit në shtetin tjetër.

Në qoftë se shteti malazez me vendbanim në një shtet tjetër nuk i kthen armët në shtetin tjetër brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni, armët i dorëzohen një tregtari armësh për t'u shitur.

Armët sipas paragrafit 8 të këtij neni mund të ekspozohen për shitje jo më vonë se gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tyre tregtarit të armëve.

Paratë e fituara nga shitja e armëve dhe municionit sipas paragrafit 8 të këtij neni, pasi të zbriten shpenzimet e shitjes, i dërgohen pronarit të armëve dhe municionit.

Me armët sipas paragrafit 9 të këtij neni, të cilat nuk shiten brenda gjashtë muajve, do veprohet në përputhje me nenin 52 paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij ligji.

Për armët sipas paragrafëve 1 dhe 8 të këtij neni, Ministria njofton organin e administratës shtetërore përgjegjës për tregtinë e jashtme.

Neni 57

Shtetasi malazez me vendqëndrim në një shtet tjetër i cili nuk leje për blerje arme, për gjueti ose pjesëmarrje në konkurse sportive mund të fusë në Mal të Zi armë gjuetie dhe sportive dhe municione për këto armë, në qoftë se janë regjistruar në dokumentin e udhëtimit.

Regjistrimi i armës dhe municionit sipas paragrafit 1 të këtij neni në dokumentin e udhëtimit kryhet nga Zyra Diplomatike Konsullore e Malit të Zi, në qoftë se shtetasi malazez disponon leje për mbajtjen e kësaj arme në bazë të dispozitave të shtetit në të cilin qëndron.

Në qoftë se armët dhe municioni sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk janë regjistruar në dokumentin e udhëtimit në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, policia kufitare kryen regjistrimin e tyre në dokumentin e udhëtimit, në qoftë se shtetasi malazez disponon leje për mbajtjen e armëve në fjalë.

Në rastin e parashikuar në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni, policia kufitare lëshon lejë për futjen e armëve dhe të municionit.

Kur personi sipas paragrafit 1 të këtij neni largohet nga Mali i Zi, policia kufitare tërheq lejen që i është dhënë në bazë të paragrafit 4 të këtij neni dhe fshin dokumentin e udhëtimit të dhënat e regjistruara për futjen e armëve dhe të municionit nga.

Neni 58

Shtetasi malazez mund të nxjerrë nga Mali i Zi armët dhe municionin e kësaj arme në bazë të kartës për regjistrim të armës për mbajtje arme, të kartës së regjistrimit të armës për zotërim dhe mbajtje të armëve, vërtetimit për armët e deklaruara dhe lejes për blerje arme.

Neni 59

Shtetasi i huaj i cili ka lejeqëndrimi të përkohshme ose të përhershme në Mal të Zi, mund të blejë, zotërojë ose të mbajë armë dhe municione për këtë armë nën të njëjtat kushte si dhe shtetasi malazez me banim në Malin e Zi.

Neni 60

Shtetasi i huaj i cili është në transit ose i cili vjen në Mal të Zi për qëllime gjuetie, mund të kalojë nëpërmjet kufirit shtetëror armën dhe municionin e kësaj arme në qoftë se ka regjistruar ato në dokumentin e udhëtimit.

Regjistrimi i armës dhe i municionit në dokumentin e udhëtimit sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet nga Zyra Diplomatike Konsullore e Malit të Zi në rast se i shtetasi i huaj sipas dispozitave të shtetit në të cilin qëndron, disponon leje për mbajtjen e kësaj arme.

Në qoftë se arma dhe municioni sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk janë regjistruar në dokumentin e udhëtimit në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, policia kufitare kryen regjistrimin e tyre në dokumentin e udhëtimit në qoftë se shtetasi i huaj disponon leje për mbajtje të kësaj arme në përputhje me dispozitat e shtetit në të cilin ka vendbanimin.

Në rastin e parashikuar në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni, policia kufitare lëshon leje për futjen e armës dhe të municionit në territorin e shtetit.

Në momentin e largimit të personit sipas paragrafit 1 të këtij neni nga Mali i Zi, policia kufitare do të sekuestrojë lejen e lëshuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni dhe fshin nga dokumenti i udhëtimit të dhënat e regjistruara për futjen e armës dhe të municionit.

Në raste të veçanta, policia kufitare, në momentin e largimit të shtetasit të huaj nga Mali i Zi, nuk do të veprojë sipas paragrafit 5 të këtij neni në qoftë se shtetasi i huaj, për shkaqe të arsyeshme (riparim, rregullim, kthim të paparashikuar etj.), armën e futur në territorin e vendit nuk e nxjerr por ia dorëzon në ruajtje një personi në Mal të Zi për një kohë më shumë se një vit.

Në rastin e parashikuar në paragrafin 6 të këtij neni, shtetasi i huaj duhet t'i japë policisë kufitare të dhënat e personit të cilit i ka dorëzuar armën në ruajtje dhe policia kufitare njofton për këtë Ministrinë.

Mënyra e konfirmimit të futjes së armëve dhe të municionit sipas nenit 56 paragrafi 4 të këtij ligji dhe mënyra e regjistrimit të armës dhe municionit në dokumentin e udhëtimit, e lëshimit të lejes për futjen e armës dhe të municionit, fshirjen e të dhënave të regjistruara për futjen e armës dhe të municionit sipas nenit 57 paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji dhe paragrafit 2, 3 dhe 4 të këtij neni, përcaktohen nga Ministria.

Neni 61

Shtetasi i huaj mund të blejë armën dhe municionin që do të nxjerrë nga Mali i Zi në qoftë se ka leje për blerje të arme dhe municioni të lëshuar në shtetin e vendbanimit të tij.

Tregtari i armëve ose personi i cili shet armë një shtetasi të huaj, është i detyruar që armën dhe municionin ta dërgojë deri në kufirin shtetëror dhe t'ia dorëzojë shtetasit të huaj në prani të punonjësit të policisë kufitare.

Neni 62

Anëtarët e organizatave të huaja të qitjeve mund të kalojnë nëpërmjet kufirit shtetëror armë sportive dhe municionin për këto armë për qëllime të pjesëmarrjes në konkurse sportive në Malin e Zi ose në një shtet tjetër në bazë të nenit 60 të këtij ligji.

Neni 63

Shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian mund të futin në Mal të Zi armë të cilat janë regjistruar në lejekalimin evropian për armët e zjarrit, në qoftë se për armët dhe municionin në fjalë Ministria ka lëshuar paraprakisht leje për futje të armëve dhe municionit.

Kërkesa për lëshimin e lejes sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet pranë Zyrës Diplomatike Konsullore të Malit të Zi në vendbanimin e shtetasit të vendit anëtar të Bashkimit Evropian sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Leja për futje armësh dhe municioni lëshohet me afat vlefshmërie prej një viti.

Afati i lejes për futje të armëve mund të zgjatet me një vit.

Leja për futje armësh dhe municioni nuk lëshohet në qoftë se ekzistojnë shkaqe që lidhen me rendin publik dhe paqen, sigurinë e personave dhe të pasurisë ose sigurinë shtetërore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, leja për futje të armëve dhe municionit nuk lëshohet në qoftë se arma është regjistruar në lejëkalimin evropian për armët e zjarrit si armë për qëllime gjuetie dhe pjesëmarrjeje në konkurse sportive ndonëse shtetasi i vendit anëtar të Bashkimit Evropian disponon dëshmi për qëllimin e futjes së tyre në Malin e Zi (ftesë, njoftim nga organizatori i konkurseve sportive ose të gjuetisë).

Neni 64

Arma e cila është regjistruar në lejëkalimin Evropian për armët e zjarrit të shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian mund ta mbahen dhe të kalojnë nëpër territorin e Malit të Zi, në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe me këtë ligj.

Me kërkesë të shtetasit të vendit anëtar të Bashkimit Evropian, Ministria lëshon lejëkalim evropian për armë në qoftë se për armën në fjalë është lëshuar kartë për regjistrim arme në bazë të këtij ligji.

Sekuestrimi i armës, dokumentit për armën dhe lejëkalimit evropian për armët e zjarrit të shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian kryhet në përputhje me këtë ligj.

Neni 65

Ministria lëshon lejë për nxjerrje të armëve nga Mali i Zi drejt një vendi anëtar të Bashkimit Evropian personit fizik që ka dokumentin përkatës për armët sipas këtij ligji dhe i cili ka marrë miratim paraprak nga vendi anëtar i Bashkimit Evropian, nëse është e nevojshme.

Ministria mund t'u lëshojë tregtarëve të huaj të armëve lejë për transport armësh në qoftë se ata disponon lejë për nxjerrjen e armëve.

Leja për nxjerrjen e armëve jashtë territorit të shtetit tregtarëve të huaj u lëshohet nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për tregtinë e jashtme.

Leja sipas paragrafit 2 të këtij neni lëshohet në qoftë se tregtari i huaj i armëve plotëson kushtet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 3, 4 dhe 5 të këtij ligji.

VI. PRODHIMI, TESTIMI, ETIKETIMI, TREGTIMI, MODIFIKIMI, RIPARIMI DHE TRANSPORTI I ARMËVE DHE MUNICIONIT

1. Prodhimi

Neni 66

Me prodhim armësh dhe municioni mund të merret shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili është regjistruar për kryerje të këtij aktiviteti dhe disponon leje nga Ministria për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të armëve.

Me prodhim armësh nënkuptohet prodhimi i armëve të reja, ndërsa me prodhim municioni nënkuptohet prodhimi i municionit të ri.

Neni 67

Shoqërisë tregtare ose sipërmarrësit sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji i lëshohet lejë, në qoftë se:

1) personi përgjegjës i personit juridik ose sipërmarrësi plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji dhe ka nivelin e shtatë, nëniveli një (VII-1) të kuadrit të brendshëm të kualifikimit;

2) disponon ambiente për prodhim dhe ruajtje të armëve ose të municionit që plotësojnë kushtet për prodhim dhe ruajtje të sigurt të armëve, si dhe mbrojtje kundër zjarrit, vjedhjes dhe aksidenteve të tjera ose keqpërdorimi;

3) ka caktuar një person për administrimin e armëve ose të municionit, gjatë prodhimit, i cili disponon lejë për administrim armësh;

Ekzistenca e kushteve sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni konfirmohet nga komisioni, i cili krijohet nga ministri i punëve të brendshme

Kushtet sipas paragrafit 1 pika 2 të këtij neni përcaktohen nga Ministria.

Neni 68

Leja për administrim armësh i lëshohet personit që plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji dhe ka kualifikimin profesional përkatës në fushën e mekanikës për profesionin armëpunues.

Leja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet nga Ministria.

Neni 69

Ambienti sipas nenit 67 paragrafi 1 pika 2 të këtij neni duhet të jetë i siguruar me mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike për parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar.

Neni 70

Me kërkesën për lëshim lejeje për prodhim armësh ose municion, bashkëlidhen:

- 1) dokumenti i regjistrimit në regjistrin qendror të shoqërive;
- 2) të dhënat e personit përgjegjës të personit juridik ose sipërmarrësit;
- 3) të dhënat e personave që do të përdorin armët dhe municionin gjatë prodhimit;
- 4) lejen e objektit prodhues dhe ruajtës;
- 5) të dhënat për llojin e armës dhe të municionit që do të prodhohen;
- 6) raporti teknik që përcakton procedurat e prodhimit;
- 7) përshkrimi i sistemit të kontrollit të cilësisë;

Neni 71

Armët dhe municioni prodhohen në përputhje me ligjin e posaçëm.

Për armën e prodhuar, shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji, kryen një testim për të verifikuar se përmbushjen e kushteve për armët e prodhuara dhe pjesët kryesore të tyre i markon me tregues unik që përmban: Emrin e prodhuesit, emrin e shtetit dhe numrin serial. Në qoftë se në numrin serial nuk është paraqitur viti i prodhimit, ai duhet paraqitur veçantë.

Për qëllime të testimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, shoqëria tregtare ose sipërmarrësi mund të blejë ose mbajë llojet dhe sasi të nevojshme të municionit ose të armëve.

Neni 72

Shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji njofton organin e administratës shtetërore përgjegjës për ekonominë për armën dhe municionin e prodhuar ose të porositur, brenda tetë ditësh nga data e prodhimit ose e porosisë.

2. Testimi dhe markimi i armëve

Neni 73

Arma e prodhuar, përpara se të vendoset në treg i nënshtrohet testimit dhe markimit me vulë ose me ndonjë shenjë identifikuese të parashikuar (në vijim referuar si: Vula).

Testimit dhe shënimit me vulë i nënshtrohet edhe arma e zjarrit pjesa kryesore e të cilës është zëvendësuar ose modifikuar me anë të riparimit,.

Neni 74

Testim i armës së zjarrit nënkupton verifikimin e funksionimit të rregullt të armës dhe të pjesëve të veçanta të saj, si dhe kontrollin e qëndrueshmërisë së tytës dhe të pjesëve të tjera përkatëse nën nën presion të caktuar.

Markimi me vulë i armës së zjarrit nënkupton shtypjen e vulave të parashikuara, në pjesë të caktuara të armës së zjarrit për të cilën është konfirmuar rregullsia nëpërmjet testimit.

Testimi i armës sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet në përputhje me dispozitat e Komisionit të Përhershëm Ndërkombëtar për testimin e armëve të zjarrit të dorës (në vijim referuar si: C.I.P), në bazë të ligjit të posaçëm.

Neni 75

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me testimin dhe markimin me vulë nuk zbatohen për armët të cilat:

- 1) importohen ose vijnë nga shtet tjetër në të cilin i janë nënshtruar testimin dhe markimit me vulë;
- 2) importohen nga shtet tjetër ekskluzivisht për qëllime kërkimore;
- 3) transportohen nëpër territorin e Malit të Zi dhe janë testuar dhe markuar me vulë në një shtet tjetër;
- 4) armët antike;
- 5) kalojnë nga pronësia e ushtrisë, policisë dhe organeve shtetërore dhe personave juridikë të tjerë në pronësi të personave fizikë, në qoftë se janë testuar dhe markuar me vulë;
- 6) prodhohen për nevoja të ushtrisë, policisë dhe organeve të tjera, në përputhje me dispozitat e posaçme ose kur për eksportohen nga Mali i Zi për këtë qëllim;
- 7) prodhohen në Mal të Zi dhe eksportohen në një shtet tjetër i cili nuk pranon testimin ose markimin e armës në bazë të dispozitave të C.I.I.-ës, ndërkohë që janë testuar dhe markuar në bazë të dispozitave dhe standardeve të shtetit në të cilin eksportohen.

Armët e zjarrit sipas paragrafit 1 pikat 1 dhe 5 të këtij neni, në qoftë se nuk janë markuar me vulë, i nënshtrohen testimin të detyrueshëm dhe markimit me vulë, i cili do të mundësojë identifikimin e vitit dhe të vendit të eksportit, ose të vitit dhe të vendit që kryen transferimin.

Neni 76

Testimi dhe markimi me vulë i armëve të zjarrit kryhet nga personat juridikë që plotësojnë kushtet për procesin e testimin dhe të markimit me vulë të armës, në përputhje me ligjin e posaçëm.

Neni 77

Arma e zjarrit e cila nuk është testuar dhe markuar nuk mund të vendoset në treg.

3. Mbushjet individuale të municionit për nevojat personale

Neni 78

Personi fizik i cili ka kartë të vlefshme për regjistrim të armëve për zotërim dhe mbajtje të tyre mund të kryejë mbushje individuale të municionit për nevojat e veta, ekskluzivisht për qëllime të gjuetisë dhe qitjes sportive.

Mbushje individuale të municionit nënkupton mbushje municioni për nevojat e veta për armën me tytë të vjaskuar dhe të pavjaskuar, si dhe municionin në formën e saçmeve.

Personi fizik sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jetë i trajnuar profesionalisht për mbushje individuale të municionit, për të cilin lëshohet një certifikatë.

Trajnimi sipas paragrafit 3 të këtij neni kryhet nga organizata e qitjes ose e gjuetisë, e cila ka kuadrin profesional përkatës ose angazhon kuadër profesional nga Mali i Zi ose një shtet tjetër.

Organizata e gjuetisë ose e qitjes sipas paragrafit 4 të këtij neni lëshon certifikatë që tregon se personi fizik sipas paragrafit 1 të këtij neni është i aftësuar për mbushje individuale të municionit.

Për certifikatat e dhëna sipas paragrafit 5 të këtij neni, organizata e gjuetisë ose e qitjes është e detyruar të njoftojë Ministrinë brenda tetë ditësh nga data e lëshimit të saj.

Personi fizik sipas paragrafit 3 të këtij neni mund të prokurorë ose disponorë komponentë të veçantë të fishekëve: maksimumi 5 kg mbushje baruti, maksimumi 3000 copë kapsolla dhe gëzhoja dhe predha pa kufizim, për të cilat do të tregojë kujdesin e duhur në përputhje me dispozitat e nenit 34 të këtij ligji.

Mbushje individuale municioni konsiderohet prodhimi i municionit dhe nuk i nënshtrohet testimin të detyrueshëm.

Mbushjet individuale të municionit nuk mund të vendoset në treg apo t'i jepet një personi tjetër.

Përmbajtja dhe forma e certifikatës sipas paragrafit 3 të këtij neni i përcaktohet nga Ministria.

4. Tregtia dhe ndërmjetësimi në tregtinë e armëve dhe municionit

Neni 79

Me tregtim të armëve dhe municionit mund të merret shoqëria tregtare ose sipërmarrës i cili është regjistruar për kryerjen e këtij aktiviteti dhe zotëron leje nga Ministria për kryerjen e tregtisë së armëve dhe municionit.

Me tregtim të armëve dhe municionit nënkuptohe tregtimi me shumicë dhe pakicë, si dhe ndërmjetësimi në tregtimin e armëve dhe municionit ndërmjet pronarit dhe blerësit (në vijim referuar si: Komisioni i Shitjes).

Shoqërisë tregtare ose sipërmarrësit i lëshohet leje sipas paragrafit 1 të këtij neni në qoftë se:

1) personi përgjegjës i personit juridik ose sipërmarrësit plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji;

2) disponon ambiente për shitje ose për ruajtje të armëve dhe të municionit, të cilat plotësojnë kushtet për ruajtje të sigurt të armëve dhe municionit dhe ofrojnë mbrojtje kundër zjarrit, vjedhjes dhe aksidenteve ose keqpërdorimeve të tjera.

Përmbushja e kushteve sipas paragrafit 3 pika 2 të këtij neni konfirmohen nga komisioni sipas nenit 67 paragrafi 2 të këtij ligji.

Tregtia me pakicë e armëve dhe municionit nënkupton shitjen e armëve, municionit dhe komponentëve të veçantë të fishekëve, në ambiente të shitjes me pakicë, si dhe komisionin e shitjes. Sasia e përgjithshme e barutit të përmbajtur në municionin që ekspozohet në vende të dukshme në ambientin e shitjes me pakicë nuk duhet të kalojë 40 kg të peshës neto të lëndës plasëse ose 200 kg në magazinën për ruajtje të sigurt të armëve dhe municionit në ambientin e shitjes me pakicë, ndërsa sasia maksimale e lejuar e pajisjeve piroteknike parashikohet me rregullore të veçantë.

Në ambientin e shitjes me pakicë mund të shiten edhe pajisje piroteknike të kategorisë I, II, III, P1 dhe T1, në qoftë se ambienti në fjalë plotëson kushtet në përputhje me ligjin që rregullon lëndët plasëse.

Kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 pika 2 të këtij neni përcaktohen nga Ministria.

Neni 80

Ambienti i shitjes me pakicë sipas nenit 79 paragrafi 6 të këtij ligji duhet të ketë mbrojtje teknike të përhershme për të parandaluar hyrjen e personave të paautorizuar.

Ambienti për ruajtje në të cilin vendoset dhe ruhet arma dhe municioni i destinuar për tregti me shumicë duhet të plotësojë kushtet sipas nenit 67 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji.

Neni 81

Me kërkesën për lëshim të lejes për tregti armësh dhe municioni bashkëlidhen:

- 1) dokumenti i regjistrimit në regjistrin qendror të shoqërive;
- 2) të dhënat e personit përgjegjës të personit juridik ose të sipërmarrësit
- 3) të dhëna për ambientet për shitje ose ruajtje të armëve dhe municionit sipas nenit 79 paragrafi 3 pika 2 e këtij ligji.

Neni 82

Për armën e shitur të kategorisë B dhe C, shoqëria tregtare, ose sipërmarrësi duhet të njoftojë Ministrinë brenda tetë ditësh nga data e shitjes së armës.

Neni 83

Ndërmjetësi në tregtinë e armëve duhet të jetë i regjistruar për kryerjen e këtij aktiviteti dhe të ketë leje nga Ministria për ndërmjetësim në tregtinë e armëve.

Shoqërisë tregtare ose sipërmarrësit i lëshohet leje sipas paragrafit 1 të këtij neni, në qoftë se personi përgjegjës i personit juridik ose sipërmarrësi plotëson kushtet e përgjithshme sipas nenit 13 paragrafi 1 i këtij ligji.

Me kërkesën për lëshimin e lejes sipas paragrafit 1, bashkëlidhen edhe:

- 1) dokumenti i regjistrimit në regjistrin qendror të shoqërive;
- 2) të dhënat e personit përgjegjës të personit juridik ose sipërmarrësit

5. Riparimi dhe modifikimi i armëve

Neni 84

Riparimi dhe modifikimi i armëve mund të kryhet nga shoqëria tregtare ose sipërmarrës i cili është regjistruar për kryerjen e këtij aktiviteti dhe ka leje nga Ministria për kryerjen e aktivitetit të riparimit dhe modifikimit të armëve.

Me riparim të armëve nënkuptohet eliminimi i defekteve të armëve dhe zëvendësimi ose montimi i pjesëve origjinale të tyre më qëllim që armët të jenë të rregullta nga ana funksionale dhe teknike.

Riparimi i armëve nënkupton përshtatjen e armëve për përdorim të një municioni tjetër, zëvendësimin ose montimin e pjesëve kryesore dhe ndërhyrje të tjera në armë, të cilat ndikojnë në funksionimin ose në karakteristikat teknike të tyre.

Shoqërisë tregtare ose sipërmarrësit i lëshohet leje sipas paragrafit 1 të këtij neni, në qoftë se:

1) personi përgjegjës i personit juridik ose sipërmarrësit plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji;

2) disponon ambiente për riparim dhe modifikim të armëve ose për ruajtjen e armëve dhe municionit, të cilat plotësojnë kushtet për ruajtjen e sigurt të armëve dhe municionit dhe kanë mbrojtje kundër zjarrit, vjedhjes dhe aksidenteve ose keqpërdorimeve të tjera;

3) ka caktuar një person për administrimin e armëve ose të municionit gjatë prodhimit, i cili është i pajisur me leje sipas nenit 68 të këtij ligji.

Ekzistenca e kushteve sipas paragrafit 4 pika 2 të këtij neni konfirmohet nga komisioni sipas nenit 67 paragrafi 2 të këtij ligji.

Kushtet sipas paragrafit 4 pika 2 të këtij neni përcaktohen nga Ministria.

Neni 85

Ambientet sipas nenit 84 paragrafi 4 pika 2 të këtij ligji duhet të kenë mbrojtje teknike të përhershme për parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar.

Neni 86

Me kërkesën për lëshim leje për kryerjen e aktivitetit të riparimit dhe modifikimit të armëve, bashkëlidhen:

1) dokumenti i regjistrimit në regjistrin qendror të shoqërive;

2) të dhënat e personit përgjegjës të personit juridik ose sipërmarrësit

3) të dhënat e personave që do të administrojnë armët.

Neni 87

Shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 84 paragrafi 1 të këtij ligji, për armën e riparuar ose të modifikuar kryen testimin për verifikimin e rregullsisë funksionale dhe teknike të saj.

Për qëllime të testimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 84 paragrafi 1 të këtij ligji mund të prokurojë ose mbajë llojet dhe sasi të nevojshme të municionit ose të armës.

Neni 88

Shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 84 paragrafi 1 të këtij ligji mund të marrë për riparim ose modifikim vetëm armën e pajisur me dokument të vlefshëm për armën.

Shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 84 pika 1 të këtij ligji njofton Ministrinë për modifikimet e armëve, brenda tetë ditësh nga data e modifikimit të tyre.

Në lidhje me çaktivizimin e përhershëm të armës së zjarrit, shoqëria tregtare ose sipërmarrësi sipas nenit 84 paragrafi 1 të këtij ligji, i lëshojnë një vërtetim pronarit të armës.

Neni 89

Arma e pranuar për riparim ose modifikim nuk duhet të ekspozohet në ambientet sipas nenit 84 paragrafi 4 pika 2 të këtij ligji deri në dorëzimin saj te pronari i armës.

Në raste të veçanta, arma e marrë për riparim ose modifikim mund të ekspozohet në ambientet e caktuara për punë deri në dorëzimin e saj te pronari, në qoftë se kjo është e nevojshme për riparimin, modifikimin ose testimin e saj.

6. Transporti i armëve dhe municionit për qëllime tregtimi

Neni 90

Me transport armësh dhe municioni mund të merret shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili është i regjistruar për kryerjen e aktivitetit të tregtisë sipas 79 paragrafi 1 të këtij ligji dhe disponon lejë për transportin e armëve dhe municionit të lëshuar nga Ministria.

Me transport armësh nënkuptohet transporti i armëve ose municionit për qëllime të tregtimit të tyre brenda territorit të Malit të Zi (në vijim referuar si: transporti i brendshëm) ose transporti i armëve dhe municionit për qëllime të tregtimit të tyre nëpërmjet kufirit shtetëror (në vijim referuar si: transporti ndërkombëtar).

Leja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet nga Ministria.

Për armët e kategorisë C dhe D nuk nevojitet lejë për transport armësh.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, armët dhe municioni mund të transportohet nëpërmjet kufirit shtetëror vetëm në pikat e kalimit kufitar për transportin ndërkombëtar.

Neni 91

Kërkesa për lëshimin e lejes sipas nenit 90 paragrafi 1 të këtij ligji përmban të dhënat e mëposhtme::

- 1) emrin dhe adresën e dërguesit;
- 2) emrin dhe adresën e marrësit;
- 3) emrin dhe adresën e prodhuesit;
- 4) llojin, sasinë dhe mënyrën e paketimit të armëve ose të municionit, në rastin e importit, ose llojin, markën, modelin, numrin e fabrikës, kalibrin, sasinë dhe mënyrën e paketimit në rastin e eksportit;
- 5) llojin dhe treguesit e mjeteve të transportit, emrin dhe mbiemrin e drejtuesit dhe të shoqëruesve, si dhe numrin e dokumentit të udhëtimit të drejtuesit dhe të shoqëruesve;
- 6) datën e përafërt të fillimit të transportit, drejtimin e lëvizjes dhe destinacionin;
- 7) Emrin e pikës së kalimit kufitar të hyrjes dhe daljes dhe datën e transportit nëpërmjet pikës së kalimit kufitar;
- 8) masat e sigurisë për kohën e transportit;
- 9) lejen e importit ose të eksportit të lëshuar nga organi i administratës kompetente për çështjet e ekonomike, kur bëhet fjalë për transport ndërkombëtar.

Ministria mund të urdhërojë ndërmarrjen e masave të veçanta të sigurisë për kohën e transportit (drejtimin e lëvizjes, shoqërimin e dërguesit ose të transportuesit, shoqërimin me polici etj.), në rastet kur kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, për mbrojtjen e pronës dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Leja për transport armësh dhe municioni lëshohet me afat vlefshmërie prej 60 ditësh.

Neni 92

Për transportin e municionit, nga pikëpamja e masave të sigurisë, zbatohen përkatësisht rregulloret për transportin e lëndëve plasëse.

VII. POLIGONI CIVIL I QITJES

1. Qitja sportivo – rekreative

Neni 93

Shërbimet e qitjes sportivo-rekreative në poligone civile të qitjes mund të ofrohen nga personat juridikë ose sipërmarrësit të cilët janë regjistruar për kryerjen e këtij aktiviteti dhe posedojnë lejë për ofrimin e shërbimit të qitjes sportivo-rekreative në poligon civil qitje të lëshua nga Ministria.

Poligon civil qitjeje është ambienti i projektuar për qitje sportivo rekreative, i cili plotëson kërkesat teknike dhe të sigurisë për përdorim të sigurt të armëve.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për vendet e caktuara për ushtrime qitje nga organizatat e gjuetisë ose të qitjes, për ushtrime qitjeje dhe për testimin e armëve të gjuetisë ose të

qitjes ose për organizimin e garave të qitjes.

Neni 94

Personit juridik ose sipërmarrësit i lëshohet lejë sipas nenit 93 paragrafi 1 të këtij ligji, në qoftë se:

- 1) personi përgjegjës i personit juridik ose sipërmarrësit plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji;
- 2) zotëron poligon civil dhe ambiente për ruajtje të sigurt të armëve dhe municionit dhe mbrojtje kundër zjarrit, vjedhjeve dhe aksidenteve ose keqpërdorimeve të tjera;
- 3) ka një person profesionist që plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 i këtij ligji dhe është i kualifikuar profesionalisht për trajnimin e personave mbi përdorimin e sigurt të armëve.

Ekzistenca e kushteve sipas paragrafit 1 pika 2 të këtij ligji konfirmohet nga komisioni sipas nenit 67 paragrafi 2 i këtij ligji.

Kushtet sipas paragrafit 1 pika 2 të këtij neni përcaktohen nga Ministria.

Neni 95

Ambientet sipas nenit 94 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji duhet të kenë mbrojtje teknike të përhershme për parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar.

Neni 96

Me kërkesën për lëshim të lejes sipas nenit 93 paragrafi 1 të këtij ligji, bashkëlidhen:

- 1) dokumenti i regjistrimit në regjistrin qendror të shoqërive;
- 2) të dhënat e personit përgjegjës të personit juridik ose të sipërmarrësit;
- 3) të dhënat e profesionistit sipas nenit 94 paragrafi 1 pika 3 të këtij neni;
- 4) leja e përdorimit për poligonin civil të qitjes;
- 5) raporti teknik i poligonit civil të qitjes.

Neni 97

Në poligonin civil të qitjes, armë mund të përdorë vetëm personi fizik i cili, në përputhje me këtë ligj, disponon kartë regjistrimi arme për mbajtje arme ose kartë regjistrimi të armës për zotërim dhe mbajtje armësh ose lejë për zotërim arme.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, në poligon civil qitjeje mund të përdorë armë, nën mbikëqyrjen e profesionistit, personi fizik i cili merret aktivisht me qitje sportive, si dhe person fizik i cili merret me qitje rekreative.

Profesionisti sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji.

Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen edhe për vendet e caktuara për ushtrime qitje.

Neni 98

Personi juridik ose sipërmarrësi sipas nenit 93 paragrafi 1 të këtij ligji mund të prokurojë sasi të nevojshme të armëve dhe municionit të synuara për përdorim në poligonin civil të qitjes.

2. Aftësimi i qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit

Neni 99

Me aftësim të qytetarëve për përdorim të armëve të zjarrit mund të merret personi fizik ose sipërmarrësi sipas nenit 93 paragrafi 1 i këtij ligji.

Personi juridik ose sipërmarrësi sipas paragrafit 1 të këtij neni i lëshon personit fizik një certifikatë të aftësitimit për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit.

Në mënyrë më të detajuar, aftësimi i qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit përcaktohet nga Ministria.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 100

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji kryhet nga Ministria.

IX. EVIDENCAT

Neni 101

Ministria mban regjistrat për: lejet e lëshuara për prokurim armësh, kartat e regjistrimit të armëve për zotërim arme, kartat e regjistrimit të armëve për zotërim dhe mbajtje arme, lejet për zotërim arme, lejet për koleksionim të armëve të vjetra, lejet për administrim armësh, lejëkalimet evropiane dhe dokumente të tjera për armët, të lëshuara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara; armët të kategorisë C që janë raportuar; armët dhe municionin e dorëzuar; armët dhe municionin e sekuestruar; lejet e lëshuara për: prodhim armësh dhe municioni, tregti armësh dhe municioni, ndërmjetësim në tregtinë e armëve; riparim dhe modifikim armësh, transport armësh dhe municioni, si dhe lejet e lëshuar për ofrim të shërbimit të qitjes sportive rekreative në poligon civil qitjeje dhe për aftësimin e qytetarëve mbi përdorimin e rregullt të armëve të zjarrit; lejet për rimbushje individuale të municionit, të lëshuara nga organizata e gjuetisë ose nga organizata e qitjes.

Policia mban regjistra për: raportimet për humbje, vjedhje dhe gjetje armësh dhe municioni; armët dhe municionin e gjetur; armët dhe municionin e sekuestruar përkohësisht, si dhe dokumentet e armëve; armët e kaluara nëpërmjet kufirit shtetëror dhe lejet e lëshuara për futjen e armëve dhe municionit në territorin e shtetit.

Zura Diplomatike Konsullore e Malit të Zi administron regjistrat për regjistrimin e armëve dhe municionit në dokumentin e udhëtimit.

Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e shëndetësore administron regjistrat e vërtetimeve mjekësore të aftësisë për të zotëruar dhe mbajtur armë të lëshuara.

Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet ekonomike administron regjistrin e armëve dhe municioneve të prodhuara dhe të dorëzuara.

Të dhënat personale të pasqyruara në paragrafin 1 dhe 5 të këtij neni, përpunohen në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat sipas paragrafit 1 dhe 5 të këtij neni mbahen në format elektronik.

Të dhënat e regjistrave sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4 të këtij neni, ruhen për pesë vjet, ndërsa të dhënat sipas paragrafëve 1 dhe 5 të këtij neni, ruhen përgjithmonë.

Neni 102

Regjistrat mbahen nga:

1) personi fizik ose juridik i cili zotëron lejë për koleksionim të armëve të vjetra, regjistrin e armëve të vjetra të koleksionuara;

2) shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili zotëron lejë për prodhim armësh dhe municioni, mban regjistrin e armëve dhe municionit të prodhuar dhe të dorëzuar, si dhe të testimeve dhe markimeve me vulë të armëve dhe të municionit dhe të pjesëve kryesore të tyre;

3) shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili zotëron lejë për tregtim armësh dhe municioni, mban regjistrin e armëve dhe të municionit të blerë dhe të shitur;

4) shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili zotëron lejë për ndërmjetësim në tregtinë e armëve, mban regjistrin e prokurimeve, shitjeve ose transferimeve përkatëse të armëve nga prodhuesi te tregtari i armëve;

5) shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili posedon lejë për riparim dhe riparim armësh, mban regjistrin e: armëve të riparuar dhe të modifikuara, të testimeve të armëve dhe të armëve të çaktivizuar përgjithmonë;

6) shoqëria tregtare ose sipërmarrësi i cili është i pajisur me lejë për transport armësh dhe municionesh, mban regjistrin e transporteve të kryera të armëve dhe të municionit, të dërguesit, marrësit, prodhuesit dhe të llojit dhe sasisë së armëve dhe të municionit të transportuar;

7) personi juridik ose sipërmarrësi i cili ka lejë për ofrimin e shërbimit të qitjes sportive – rekreative në poligon civil qitjeje, si dhe për aftësimin e qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit, mban regjistrin e armëve e blera, përdorimeve të armëve, municioneve të blera dhe të përdorura, si dhe të certifikatave të lëshuara mbi kualifikimet për përdorim të rregullt të armëve të

zjarrit;

8) organizata e gjuetisë ose sportive, mban regjistrin e vërtetimeve të lëshuara për mbushje individuale të municionit.

Regjistrat sipas paragrafit 1 pikat 1 dhe 5 të këtij neni ruhen përgjithmonë, ndërsa regjistrat sipas paragrafit 1 pikat 6, 7 dhe 8 të këtij neni, ruhen për pesë vjet.

Në rast se shoqëria tregtare, një personi tjetër juridik ose sipërmarrësi nuk ekziston më, regjistrat e administruar në bazë të paragrafit 1 pikat 1, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni i dorëzohen Ministrisë, ndërsa regjistrat sipas paragrafit 1 pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni i dorëzohen organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet ekonomike.

X. DISPOZITAT PENALE

Neni 103

Për shkelje nga personat juridikë do të vendoset një gjobë në vlerën 500 deri në 20 000 euro, në rast se:

1) nuk njofton Ministrinë për shitjen e armëve një personi fizik ose juridik, brenda tetë ditësh nga data e shitjes së tyre në bazë të lejes për blerje armësh (neni 29 paragrafi 3);

2) nuk njofton Ministrinë për shitjen e armëve, brenda tetë ditësh nga data e shitjes së armëve një personi fizik për të cilat është lëshuar dokument për armët ose një personi juridik që posedon leje për blerje armësh (neni 29 paragrafi 4);

3) armët dhe municionet nuk i ruan në mënyrë të sigurt, të mbyllura dhe të ndara në armatura metalike, kasa ose pajisje të ngjashme, në mënyrë që të mos bien në duart e personave të paautorizuar, veçanërisht të personave të mitur (neni 34 paragrafi 1);

4) nuk i mban armët në gjendje të rregullt ose nuk e administron mirë atë (neni 36 paragrafi 1);

5) ia jep armët në përdorim personave të mitur, përveç rastit të parashikuar në nenin 36 paragrafi 4 të këtij ligji (neni 36 paragrafi 5);

6) transporton nga një vend në tjetrin armë gjuetie apo sportive të shkurtra ose të gjata për të cilat disponon dokument arme dhe municione të mbushura gati për përdorim, jo në kutitë, arkat ose këllëfët përkatës, të ndara nga municioni (neni 36 paragrafi 6 dhe neni 28 paragrafi 3);

7) personi sipas nenit 37 paragrafi 2 të këtij ligji përdor armët sipas nenit 37 paragrafi 1 të këtij ligji pa autorizim për zotërim, mbajtje dhe transport të në fjalë dhe municionit në fjalë (neni 37 paragrafi 2);

8) nuk denoncon menjëherë humbjen ose vjedhjen e armëve dhe municionit (neni 39 paragrafi 1);

9) armën dhe municionin që ia shet një shtetasi të huaj nuk e dërgon deri në kufirin shtetëror dhe nuk ia dorëzon shtetasit në fjalë në prani të punonjësit të policisë kufitare (neni 61 paragrafi 2);

10) nuk siguron ambientin sipas nenit 67 paragrafi 1 pika 2 nuk e siguron me mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike për parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar (neni 69);

11) nuk kryen testimin e armëve të riparuar dhe të modifikuara për të verifikuar rregullsinë funksionale dhe teknike të tyre (neni 87 paragrafi 1);

12) nuk njofton Ministrinë për riparimin e armëve brenda tetë ditësh nga data e kryerjes së riparimit (neni 88 paragrafi 2);

13) nxjerr armët e pranuar për riparim ose modifikim jashtë ambienteve sipas nenit 84 paragrafi 4 pika 2 të këtij ligji, përpara dorëzimin të tyre te pronari, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 89 paragrafi 2 të këtij ligji (neni 89);

14) transporton armë dhe municion në bazë të lejes për transport armësh dhe municioni, në kundërshtim me masat e sigurisë të përcaktuara në këtë leje (neni 90);

15) lejon përdorimin e armës në poligon civil qitjeje nga një person fizik i cili nuk ka kartë regjistrimi arme për mbajtje arme ose kartë për regjistrim arme për qëllime zotërimi dhe mbajtje arme ose leje për mbajtje arme, pa mbikëqyrjen e profesionistit (neni 97 paragr. 1 dhe 2);

16) nuk mban regjistrin mbi koleksionimin e armëve të vjetra, në bazë të lejes për koleksionim armësh të vjetra (neni 102 paragrafi 1 pika 1);

17) Nuk mban regjistrin për: armët dhe municionin e prodhuar dhe të dorëzua, testimin dhe markimin me vulë të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, armën dhe municionin e blerë

dhe të shitur, blerjet, shitjet ose transferimet e kontraktuara të armëve ndërmjet prodhuesit dhe tregtarit të armëve, për armatimin e riparuar dhe të modifikuar, testimin e armatimit, çaktivizimin e përhershëm të armëve, transportin e armëve dhe të municionit, armët e blera dhe përdorimet e tyre, municionet e blera dhe të përdorura, si dhe për vërtetimet e dhëna për mbushje individuale dhe certifikatat e aftësisë për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit (neni 102 paragrafi 1 pik. 2 deri në 8).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni vendoset gjobë në vlerën 200 deri në 2000 euro, për personin përgjegjës të subjektit juridik.

Për shkeljet sipas paragrafit 1 pika 5 të këtij neni komunikohet edhe masa e sigurisë “sekuestrim i armëve dhe municionit”.

Neni 104

Për shkelje nga personat juridikë do të vendoset gjobë në vlerën 150 euro, në rast se:

1) lejen për prokurim armësh që nuk është shfrytëzuar, nuk e kthen brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj (neni 22 paragrafi 3);

2) nuk bën kërkesë për marrje dokumenti të ri për armën brenda 30 ditësh nga data e skadimit të vlefshmërisë së dokumentit të saj (neni 24 paragrafi 1);

3) armën e blerë të kategorisë C nuk e raporton në Ministri brenda tetë ditësh nga data e blerjes së saj (neni 27 paragrafi 2);

4) nuk njofton Ministrinë brenda tetë ditësh nga data e shitjes së armës së kategorisë C (neni 27 paragrafi 4);

5) disponon armë në bazë të dokumentit për armë dhe, kur ndryshon të dhënat personale, nuk bën kërkesë për lëshim dokumenti arme me këto të dhëna, brenda 15 ditësh nga data e ndryshimit të tyre (neni 41).

Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet gjobë në vlerën 50 euro.

Neni 105

Sipërmarrësi dënohet me gjobë nga 150 deri në 6000 euro, në qoftë se:

1) nuk njofton Ministrinë për shitjen armëve në bazë të lejes për prokurim armësh, brenda tetë ditësh nga data e shitjes së saj (neni 29 paragrafi 3);

2) nuk i raporton armët e shitura brenda tetë ditësh nga shitja e tyre (neni 29 paragrafi 4);

3) armët dhe municionin nuk i ruan në mënyrë të sigurt, të mbyllura dhe të veçuara në armatura metalike, kasa ose objekte të ngjashme, në mënyrë që të mos bien në duart e personave të paautorizuar, veçanërisht të personave të mitur (neni 34 paragrafi 1);

4) nuk i mban armët në gjendje të rregullt ose nuk e administron mirë atë (neni 36 paragrafi 1);

5) ia ep armën për përdorim një personi të mitur të ndryshëm nga ai i përmendur në nenin 36 paragrafi 4 të këtij ligji (neni 36 paragrafi 5);

6) transporton nga një vend në tjetrin armë gjuetie apo sportive të shkurtra ose të gjata për të cilat disponon dokument arme dhe municione të mbushura gati për përdorim, jo në kutitë, arkat ose këllëfët përkatës, të ndara nga municioni (neni 36 paragrafi 6 dhe neni 28 paragrafi 3);

7) personi sipas nenit 37 paragrafi 2 të këtij ligji përdor armët sipas nenit 37 paragrafi 1 të këtij ligji pa autorizim për zotërim, mbajtje dhe transport të në fjalë dhe municionit në fjalë (neni 37 paragrafi 2);

8) nuk denoncon menjëherë humbjen ose vjedhjen e armës dhe municionit (neni 39 paragrafi 1);

9) nuk i raporton policisë kufitare armën dhe municionin që synon të kalojë nëpërmjet kufirit shtetëror (neni 55);

10) armën dhe municionin që ia shet një shtetasi të huaj nuk e dërgon deri në kufirin shtetëror dhe nuk ia dorëzon atij shtetasi në prani të punonjësit të policisë kufitare (neni 61 paragrafi 2);

11) ambientin sipas nenit 67 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji nuk e siguron me mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike për parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar (neni 69);

12) nuk kryen testimin e armëve të riparuar dhe të modifikuara për të verifikuar rregullsinë

funkionale dhe teknike të tyre (neni 87 paragrafi 1);

13) nuk njofton Ministrinë për riparimin e armëve, brenda tetë ditësh nga data e riparimit të tyre sipas nenit 84 paragrafi 1 të këtij ligji (neni 88 paragrafi 2);

14) armët e pranuar për riparim dhe modifikim i ekspozon jashtë ambienteve të përcaktuara në nenin 84 paragrafi 4 pika 2 të këtij ligji, përpara dorëzimit të tyre pronarit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 89 paragrafi 2 të këtij ligji (neni 89);

15) Transporton armë dhe municion në bazë të licencës për transport armatimi dhe municioni, në kundërshtim me rregullat dhe masat e përcaktuara në këtë licencë (neni 90);

16) lejon përdorimin e armëve, në poligone civile, nga persona fizikë të cilët nuk disponojnë kartë për regjistrim arme për zotërim arme ose kartë për regjistrim arme për zotërim dhe mbajtje ose leje për zotërim arme, pa mbikëqyrjen e profesionistit (neni 97 paragr. 1 dhe 2);

17) nuk mban regjistrat e armëve të vjetra të koleksionuara në bazë të lejes për koleksionim armësh të vjetra (neni 102 paragrafi 1 pika 1);

18) nuk mban regjistrat për: armët dhe municionin e prodhuar dhe të dorëzuar, testimet dhe markimet me vulë të armëve të zjarrit dhe të pjesëve kryesore të tyre, armët dhe municionet e blera dhe të shitura, prokurimet, shitjet dhe transferimet e kontraktuara të armëve ndërmjet prodhuesve dhe shitësve të armëve, armët e riparuar dhe të modifikuara, testimet e armëve, çaktivizimet e përhershme të armëve, transportimet e armëve dhe të municionit, armët e blera dhe të përdorura, municionet e blera dhe të harxhuara, si dhe vërtetimet e dhëna për mbushje individuale të municionit dhe vërtetimet mbi aftësitë për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit (neni 102 paragrafi 1 pikat 2 deri në 8).

Për shkelje sipas paragrafit 1 deri në 5 të këtij neni, jepet edhe masa e sigurisë “sekuestrim i armës dhe municionit”.

Neni 106

Sipërmarrësi dënohet me gjobë në vlerën 100 euro për kundërvajtje, në qoftë se:

1) nuk kthen lejen për prokurim armësh që nuk është shfrytëzuar, brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë (neni 22 paragrafi 3);

2) nuk bën kërkesë për lëshimin e një lejeje të re për armë, brenda 30 ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë (neni 24 paragrafi 1)

3) nuk u raporton Ministrisë armët e kategorisë C që ka blerë, brenda tetë ditësh nga data e blerjes së tyre (neni 27 paragrafi 2);

4) nuk njofton Ministrinë brenda tetë ditësh nga data e shitjes së armës së kategorisë C (neni 27 paragrafi 4);

5) zotëron dhe mban dhe armë të kategorisë B për të cilën disponon një dokument të vlefshëm arme, pa dokumentin në fjalë (neni 28);

6) disponon armë në bazë të dokumentit të armës dhe, kur ndryshon të dhënat personale, nuk bën kërkesë për lëshim dokumenti arme me këto të dhëna, brenda 15 ditësh nga data e ndryshimit të tyre (neni 41).

Neni 107

Me gjobë nga 30 deri në 500 euro dënohet për shkelje personi fizik në qoftë se:

1) nuk bën kërkesë për lëshim të kartës për regjistrim arme për zotërim arme ose të kartës për regjistrim arme për zotërim dhe mbajtje arme, brenda tetë ditësh nga data e blerjes së armës (neni 23 paragrafi 1);

2) armën e kategorisë B që disponon në bazë të një dokumenti të vlefshëm, e mban ose e transporton pa këtë dokument (neni 28);

3) nuk njofton Ministrinë për shitjen e armës, brenda tetë ditësh nga data e shitjes së armës në bazë të lejes për blerje arme, me qëllim çregjistrimin e saj (neni 29 paragrafi 4);

4) nuk njofton Ministrinë për çregjistrimin armës brenda tetë ditësh nga data e çaktivizimit të përhershëm të saj, me anë të vërtetimit sipas nenit 88 paragrafi 3 të këtij ligji (neni 31 paragrafi 4);

5) nuk tregon kujdesin e duhur me armën dhe municionin (neni 32);

6) e mban armën në ambiente ose vende publike të caktuara në të cilat ndalohet mbajtja e armëve (neni 33 paragrafi 2);

7) mban dhe përdor armë nën ndikimin e alkoolit, drogës ose të substancave të tjera

psikoaktive ose kur nuk është në gjendje që të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij ose të kontrollojë veprimet e tij (neni 33 paragrafi 6);

8) armën e kategorisë B, C dhe D e ekspozon ndaj personave të tjerë ose e mban në një mënyrë që shqetëson qytetarët (neni 33 paragrafi 7);

9) armët dhe municionin nuk i ruan në mënyrë të sigurt, të mbyllura dhe të veçuara në armatura metalike, kasa ose objekte të ngjashme, në mënyrë që të mos bien në duart e personave të paautorizuar, veçanërisht të personave të mitur (neni 34 paragrafi 1);

10) nuk e mban armën në gjendje të rregullt ose nuk e përdor atë në mënyrë të rregullt (neni 36 paragrafi 1);

11) ia jep armën për përdorim një personi të mitur të ndryshëm nga ai i përcaktuar në nenin 36 paragrafi 4 të këtij ligji (neni 36 paragrafi 5);

12) transporton nga një vend në tjetrin armë gjuetie apo sportive të shkurtra ose të gjata për të cilat disponon dokument arme dhe municione të mbushura gati për përdorim, jo në kutitë, arkat ose këllëfët përkatës, të ndara nga municioni (neni 36 paragrafi 6 dhe neni 28 paragrafi 3);

13) personi sipas nenit 37 paragrafi 2 të këtij ligji përdor armët sipas nenit 37 paragrafi 1 të këtij ligji pa autorizim për zotërim, mbajtje dhe transport të në fjalë dhe municionit në fjalë (neni 37 paragrafi 2);

14) i huazon armë që nuk është sportive, gjuetie ose të vjetra një personi që nuk ka dokument për këtë lloj arme (neni 38 paragrafi 1);

15) nuk denoncon menjëherë në polici humbjen ose vjedhjen e armës dhe të municionit (neni 39 paragrafi 1);

16) nuk i deklaron policisë kufitare armën dhe municionin që synon të kalojë nëpërmjet kufirit shtetëror (neni 55);

17) armën dhe municionin që ia shet një shtetasi të huaj nuk e dërgon deri në kufirin shtetëror dhe nuk ia dorëzon atij në prani të punonjësit të policisë kufitare (neni 61 paragrafi 2);

18) një person sipas nenit 78 paragrafi 3 të këtij neni disponon më shumë se 5 kg mbushje baruti ose më shumë se 3000 copë kapsolla ose në qoftë se nuk i ruan ato në bazë të dispozitave të nenit 34 të këtij ligji (neni 78 paragrafi 7).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1, pikat 7 dhe 11 të këtij neni, vendoset edhe masa e sigurisë “sekuestrim arme dhe municioni”

Neni 108

Me gjobë në vlerën 50 euro dënohet për shkelje personi fizik i cili:

1) lejen për prokurim armësh që nuk është shfrytëzuar, nuk e kthen brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj (neni 22 paragrafi 3);

2) nuk bën kërkesë për marrje dokumenti të ri për armën brenda 30 ditësh nga data e skadimit të vlefshmërisë së dokumentit të saj (neni 24 paragrafi 1);

3) armën e blerë të kategorisë C nuk e raporton në Ministri brenda tetë ditësh nga data e blerjes së saj (neni 27 paragrafi 2);

4) disponon armë në bazë të dokumentit për armë dhe, kur ndryshon të dhënat personale, nuk bën kërkesë për lëshim dokumenti arme me këto të dhëna, brenda 15 ditësh nga data e ndryshimit të tyre (neni 41).

5) Për shkelje sipas paragrafit 1 të këtij neni, personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet gjobë në vlerën 50 euro (neni 42 paragrafi 1).

XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 109

Personi fizik që posedon armë të kategorisë A në mënyrë të paligjshme, duhet të deklarojë në polici vendin ku ndodhet arma, me qëllimin për ta dorëzuar ose çaktivizuar.

Punonjësi i policisë merr në dorëzim armët dhe municionin sipas paragrafit 1 të këtij neni, në vendin në të cilin ndodhen ato.

Për armët dhe municionin sipas paragrafit 2 të këtij neni të marra në dorëzim, personit fizik i lëshohet një vërtetim.

Në qoftë se personi dëshiron të çaktivizojë armën sipas paragrafit 1 të këtij neni, ai duhet të

njoftojë policinë për posedimin e kësaj arme dhe ta çaktivizojë atë brenda tetë ditësh nga data e njoftimit të policisë. Për çaktivizimin e armës, personi i dorëzon policisë vërtetimin sipas nenit 88 paragrafi 3 të këtij ligji, brenda tetë ditësh nga data e lëshimit të vërtetimit.

Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohen nga personat e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

Në qoftë se personi vepron në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kundër tij nuk do të nisë procedim penal.

Neni 110

Personi fizik që posedon armë të kategorisë A në bazë të dokumentit të armës të lëshuar në përputhje me ligjin “Për armët” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi”, numër 49/04 dhe “Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi”, nr. 49/08 dhe 20/11), duhet t’ia dorëzojë ato shtetit brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kundrejt asnjë kompensimi, ose të veprojë në përputhje me nenin 109 paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 111

Në qoftë se personi fizik posedon armë të kategorisë B pa dokument arme të lëshuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për qëllime të marrjes së kartës për regjistrim arme për zotërim arme ose të kartës për regjistrim arme për zotërim dhe mbajtje arme, ai mund t’i raportojë Ministrisë posedimin e armëve në fjalë dhe të bëjë kërkesë për lëshim të kartës së regjistrimit për armë në të cilën do të japë të dhëna të sakta për armën në fjalë, jo më vonë dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në qoftë se personi fizik nuk vepron në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ai duhet t’i deklarojë policisë posedimin e armës së kategorisë B, në vendin ku ndodhet arma, me qëllim dorëzimit ose çaktivizimit të saj, në përputhje me nenin 109 të këtij ligji.

Në qoftë se personi vepron në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, kundër tij nuk nisët procedim penal.

Neni 112

Personit që raporton posedimin e armës sipas nenit 111 paragrafi 1 të këtij neni, ministria i lëshon dokument e armës sipas nenit 23 paragrafi 3 të këtij ligji, pa identifikuar origjinën e armës, në qoftë se personi plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 13 të këtij ligji.

Në qoftë se personi nuk i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të këtij neni, arma sekuestrohet dhe me të veprohet sipas neneve 51 dhe 52 të këtij ligji.

Neni 113

Dokumentet e armëve të lëshuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji për armët e kategorisë B mund të përdoren deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, dokumentet e armëve dhe dokumentet e tjera të lëshuara me afat vlefshmërie të papërcaktuar, e humbasin vlefshmërinë brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 114

Personi fizik të cilit i është lëshuar kartë regjistrimi për zotërimin e armëve trofe në përputhje me ligjin “Për armët” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi” numër 49/04 dhe “Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi” nr. 49/08 dhe 20/11), duhet të bëjë kërkesë për lëshimin e një karte të re regjistrimi për zotërim arme ose për zotërim dhe mbajtje arme, brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ose duhet ta çaktivizojë armën dhe ta mbajë, ta shesë ose t’ia dorëzojë shtetit kundrejt asnjë kompensimi.

Neni 115

Personi fizik që posedon armë të kategorisë C në përputhje me ligjin “Për armët” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi” numër 49/04 dhe “Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi” nr. 49/08 dhe 20/11), duhet t’ia raportojë atë Ministrisë, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 116

Personi fizik ose juridik që posedon armë të kategorisë B dhe C në bazë të dokumenteve të armëve të lëshuara brenda datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t'ia dorëzojë ato shtetit kundrejt asnjë kompensimi, në përputhje me nenin 109 paragrafët 1, 3 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 117

Procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mbyllen sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 118

Shoqëritë tregtare ose sipërmarrësit të cilët kryejnë aktivitetin e prodhimit, tregtisë dhe ndërmjetësimit në tregtinë e armëve dhe municioneve, riparimit dhe modifikimit të armëve, duhet t'i harmonizojnë operacionet dhe aktivitetin e tyre me këtë ligj dhe me dispozitat e miratuara për zbatimin e këtij ligji, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 119

Personat juridikë ose sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitetin e ofrimit të shërbimeve të qitjes sportivo-rekreative në poligon civil qitjeje dhe me aftësimin e qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit duhet t'i harmonizojnë operacionet dhe aktivitetin e tyre me këtë ligj dhe me dispozitat e miratuara për zbatimin e këtij ligji, brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 120

Rregulloret për zbatimin e këtij ligji do të miratohen brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e rregulloreve sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të zbatohen rregulloret e miratuara në përputhje me ligjin "Për armët" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" numër 49/04 dhe "Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 49/08 e 20/11), në qoftë se nuk bien ndesh me këtë ligj.

Neni 121

Zbatimi i dispozitave të nenit 10 paragrafi 1 pika 6 dhe i neneve 63, 64 dhe 65 të këtij ligji do të fillojë në datën e hyrjes së Malit të Zi në Bashkimin Evropian.

Neni 122

Datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërpriten efektet e ligjit "Për armët" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" numër 49/04 dhe "Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" nr. 49/08 dhe 20/11) dhe të nenit 9 të ligjit "Për ndryshimet e ligjit që rregullon penalitetet monetare për kundërvajtje" ("Fletorja zyrtare e Republikës së Malit të Zi" numër 40/11).

Neni 123

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi".

Në këtë ligj janë transpozuar Direktiva 2008/51/KE e 21 majit 2008 dhe Direktiva 91/477/KEE e 18 qershor 1991

Numër 24-6/14-1/22

EPA 699 XXV

Podgoricë, më 26 shkurt 2015

KUVENDI I MALIT TË ZI 25. MBLEDHJE

KRYETARI

Ranko Krivokapić